



Ky projekt financohet  
nga Bashkimi Evropian



REPUBLIKA E SHqipërisë  
MINISTRIA E BRENDSHME



QENDRA E SHËRBIMEVE  
DHE PRAKTIKAVE LIGJORE TË INTEGRUARA

CENTRE OF INTEGRATED LEGAL SERVICES AND PRACTICES



Save the Children



DIFFERENT & EQUAL  
TE NDRYSEM & TE BARABARTE

## RAPORT STUDIMOR

### MBI NEVOJËN E HARTIMIT TË NJË NJË LIGJI TË VEÇANTË PËR MBROJTJEN E VIKTIMAVE TË TRAFIKIMIT

TIRANË, 2019

Ekspertë:

Z. Sandër Simoni

Znj. Anila TRIMI

Ky raport studimor u zhvillua nga Qendra “Të Ndryshëm & Të Barabartë” në kuadër të projektit “*Drejtësia është histori e vërtetë kur në plan të parë janë viktimat*”, pjesë e skemës së granteve të projektit “*Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri*”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Përmbajtja e këtij materiali jo domosdoshmërisht paraqet pikëpamjet e Bashkimit Evropian, Save the Children dhe Qendrës së Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

## **PËRMBAJTJA**

1. Parathënie
2. Lista e akronimeve
3. Hyrje - Qëllimi i raportit
4. Metodologjia - Aktivitetet e sugjeruara
5. Analiza
  - Koordinimi
  - Mbrojtja
  - Parandalimi
  - Ndjekja penale
  - Praktikat ndërkombëtare; Rasti i SHBA-ve, Mbretërisë së bashkuar dhe Kosovës
6. Konkluzione/rekomandime

## **Bibliografi**

## 1. PARATHËNIE

Ideja për hartimin e një ligji të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit ka qenë e hershme dhe ka patur mendime të ndryshme pro dhe kundër kësaj iniciative. 2011 Vitet e fundit janë shënuar disa zhvillime pozitive në drejtim të përmirësimit të legjislacionit që adreson të drejtat e viktimave të veprës penale në përgjithësi, përfshirë edhe pozitën e viktimave të trafikimit. Në kuadër edhe të reformës në drejtësi janë miratuar disa ligje që rregullojnë aspekte të veçanta të aksesit në drejtësi, përfshirë edhe disa ligje specifike për fusha dhe kategori të veçanta, siç janë ligjet organinike të Institucioneve të Drejtësisë (paketa e reformës në drejtësi), ligji për të drejtat e fëmijëve, Kodi i Drejtësë për të miturit, ndryshimet e ligjit për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare, disa ligje të tjera të reformës në shërbimet sociale etj. Kjo tregon që kemi një praktikë të konsoliduar tashmë për iniciativa ligjore që rregullojnë mbrojtjen e kategorive të veçanta.

Mbi këtë bazë, gjatë periudhës së hartimit të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore - VKM Nr. 770, datë 26.12.2018, u propozua dhe u bë pjesë masave të këtij Plani Veprimi nevoja për një analizë të thelluar për hartimin e një ligji të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Konkretisht, në Kapitullin për Ndjekjen Penale **aktiviteti 1.(a).6.**, është parashikuar masa që lidhet me *“Ngritjen e një grupi ad-hoc për kryerjen e një analize dhe vlerësimi të thelluar mbi nevojën për një ligj të veçantë me fokus mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”*.

Për ta nxitur këtë proces, në bashkëpunim të ngushtë edhe me Zyrën e Koordinatorit Kombëtar kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (ZKKA), Organizata “Të Ndryshëm & Të Bararabartë” përfshiu në objektivat e saj mbështetjen e ZKKA-së për ngritjen e këtij grupi dhe lehtësimin e procesit duke angazhuar edhe dy ekspertë me ekperince në këtë fushë. Ky aktivitet u realizua në kuadër të projektit *“Drejtësia është histori e vërtetë kur në plan të parë janë viktimat”*, i zbatuar nga Organizata “Të Ndryshëm & Të Bararabartë”, sipjesë e skemës së granteve të projektit “Përfshirja e shoqërisë civile për një sistem drejtësie funksional dhe të barabartë për të gjithë në Shqipëri”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Save the Children në partneritet me Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara.

Duke besuar se aplikimi i një qasje pro-viktimave dhe krijimi i një sistemi të integruar për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, të mbështetur në një ligj specifik do të ishte zgjidhja më e mirë, jemi mirënjohës për mbështetjen e donatorit për të lehtësuar Zyrën e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik (ZKKA) për ngritjen e grupit ad-hoc (aktiviteti i cituar më sipër). ZKKA ka qenë një partner strategjik për zhvillimin e këtij projekti dhe në këtë frymë do të vazhdojë bashkëpunimi edhe për formalizimin e iniciativës për hartimin e këtij ligji në bashkëpunim edhe me Institucionet dhe agjencitë e tjera të përfshira në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.

Iniciativa për të bërë një vlerësim të tillë vjen në një kohë kur janë shtuar argumentet ligjore për hartimin e një ligji specifik për mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Këtu I referohemi reformës në drejtësi dhe ndryshimeve ligjore në vijim të këtij procesi.

Edhe tematika e pyetësorit të fundit të Grupit të Ekspertëve për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore (GRETA), përgjegjës për vlerësimin e zbatimit të Konventës së Këshillit të Evropës për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore është e fokusuar tek marrja së masave për hedhjen e hapave konkret për përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe mjeteve efektive për mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Ajo çfarë rekomandohet edhe nga aktet ndërkombetare (Konventa e OKB-së kundër Krimit të Organizuar, Konventa e Këshillit të

Evropës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore” dhe Direktivat e BE-së) është një qasje specifike pro-viktimave të trafikimit.

Duke e parë këtë proces në këndvështrimin e mbrojtjes së viktimave të trafikimit dhe në proporcion me nevojat dhe pasojat që ato kanë krahasuar me kategoritë e tjera, hartimi i një ligji specifik për mbrojtjen e tyre bëhet i domosdoshëm.

Studimi në vijim është përgatitur nga dy ekspertë me eksperiencë të gjatë në fushëm e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe është pasuruar edhe me kontributin e grupit ad-hoc të ngritur në zbatim të Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore – VKM Nr. 770, datë 26.12.2018 për kryerjen e një analize dhe vlerësimi të thelluar mbi nevojën për një ligj të veçantë me fokus mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit (të përmendur më sipër). Pjesë e grupit ishin përfaqësues të institucioneve dhe agjencive kryesore të anazhuara në luftën kundër trafikimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit si më poshtë vijon:

Anëtarët e grupit të punës:

1. Adnand Kosova - PP
2. Alketa Gaxha - IOM
3. Anila Trimi - Eksperte
4. Artan Syziu - MD
5. Brikena Puka - VATRA
6. Eglantina Osmanli - AAPSK
7. Emanuela Tollozhina - MSHMS
8. Ilirjan Balla - DPPSH
9. Ilirjana Olldashi - GjKR
10. Ina Zhupa - Koordinatore ZKKaA – MB
11. Juliana Rexha - OSBE
12. Lira Kolasi - MB
13. Luljeta Qose - TV
14. Mariana Meshi - D&E
15. Milaim Demnushaj - Koordinator projekti – D&E
16. Mimoza Qyra - Koordinatore ZKKA – MB
17. Sandër Simoni - GjKR/ekspert
18. Sokol Shehu - AAPSK
19. Suela Asllani - QKPVT
20. Valbona Lenja - eksperte e pavarur
21. Xhilda Papajani - MSHMS

Falenderojmë dy ekspertët, anëtarët e grupit të punës, Zyrën e Koordinatorit Kombëtar dhe të gjithë bashkëpunëtorët e tjerë që ndihmuan në realizimin e këtij studimi.

Një falenderim i veçantë shkon edhe për Save the Children dhe QSHPLI që na mbështetën në çdo hap të zbatimit të këtij projekti, i cili mundësohet me financim nga Bashkimi Evropian.

Mariana Meshi

Drejtoresh Ekzekutive

Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”

## LISTA E AKRONIMEVE

AAPSK	- Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara
AP	- Autoritetit Përgjegjës
BE	- Bashkimi European
D&E	- Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë”
GJEDNJ	- Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJKR	- Gjykata për Krimet e Rënda
GRETA	- Grupii Ekspertëve për Masat kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore
ICCPR	- Marrëveshja Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike
IOM	- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin
KE	- Këshilli i Europës
KK	- Koordinator Kombëtar
KKSAT	- Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik
KM	- Këshilli i Ministrave
KP	- Kodi Penal
KPrP	- Kodi i Procedurës Penale
MASR	- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	- Ministria e Brendshme
MD	- Ministria e Drejtësisë
MKR	- Mekanizmi Kombëtar i Referimit
MSHMS	- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
OHCHR	- Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
OKB	- Organizata e Kombeve të Bashkuara
QSHPLI	- Qendra e Shërbimeve dhe Praktikave Ligjore të Integruara
OSBE	- Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë
PE	- Parlamenti Evropian
PP	- prokuroria e Përgjithshme
PSH	- Policia e Shtetit
PSV	- Procedurat Standarde të Veprimit
QKPVT	- Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit
SCH	- Save the Children
SHBA	- Shtetet e Bashkuara të Amerikës
TiP	- Trafikimi i Personave
TV	- Organizata “Tjetër Vizion”
VT	- Viktimë Trafikimi
Vatra	- Qendra Psiko Sociale “Vatra”

## HYRJE

Ky raport ka si qëllim të sjellë në vëmendje nevojën për të patur një ligj të veçantë në Shqipëri me fokus në parandalimin e trafikimit të personave dhe mbrojtjen e viktimave/ viktimave të mundshme të trafikimit, duke u bazuar në një analizë të legjislacionit të brendshëm dhe praktikave ndërkombëtare në këtë fushë. Nevoja për hartimin e një ligji të veçantë për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore është përmenduar në raporte të ndryshme të Institucioneve<sup>1</sup> dhe Organizatave Ndërkombëtare<sup>2</sup>. Raporte të tjera ndërkombëtare që vlerësojnë hapat e ndërmarrë nga qeveria Shqiptare në fushën e luftës kundër trafikimit të personave dhe identifikimit të viktimave e mbrojtjes së tyre, si edhe raportet vjetore të Drejtorisë për Antitrafikun dhe Migracionin apo të organizatave që asistojnë viktimat e trafikimit në vend, identifikojnë ende nevojën për ti kushtuar një vëmendje të veçantë kësaj forme të shkeljes së të drejtave të njeriut. Pavarësisht përpjekjeve të bëra si nga institucionet shtetërore ashtu edhe nga organizatat e shoqërisë civile, Shqipëria mbetet “një vend burimi, tranziti dhe destinacioni për burrat, gratë dhe fëmijët me qëllim shfrytëzimin seksual apo të punës<sup>3</sup>”

Në analizimin e nevojës për të patur një ligj të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, së pari ne duhet të analizojmë nivelin e legjislacionit tonë kundër trafikimit dhe sa mbulon ky legjislacion tërësinë e standardeve ndërkombëtare për parandalimin e trafikimit, identifikimin, mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin pavarësisht bashkëpunimit apo jo me organet e zbatimit të ligjit, trajtimin e veçantë të viktimave të trafikimit, kompensimin e tyre dhe përmbushjen e garancive procedurale gjatë fazës së ndjekjes penale, hetimit të këtyre veprave dhe gjyqimit të tyre.

---

<sup>1</sup> Nevoja për hartimin e një ligji specifik për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore ka qenë pjesë e rekomandimeve të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore – Raporti për vitin 2012, fq. 5 <https://mb.gov.al/raporte-mbi-zbatimin-e-strategjive-dhe-planeve-kombetare-te-veprimit/>

<sup>2</sup> Rekomandim I OSBE-së paraqitur në “Raportin e vlerësimit për përputhshmërinë e legjislacionit shqiptar me Konventën e Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, publikuar nga Zyra e OSBE-së në Shqipëri, në mars 2011.

Government of Albania and United Nations Program of Cooperation 2012-2016, on page 69, Outcome 4.1: The rights of disadvantaged individuals and groups are equally ensured through legislation, inclusive policies, social protection mechanisms and special Indicator 4: Number of legal acts addressing issues related to trafficking in human beings and children, **Target: 1 inclusive bill law on antitrafficking** <http://www.un.org.al/sites/default/files/GoA-UN-Cooperation-ProgrammeSIGNED.pdf>

<sup>3</sup> TiP report 2019, fq.69

Legjislacioni shqiptar ka evoluar në kohë në këtë drejtim e tashmë mund të themi se ne kemi një standard të konsiderueshëm në nivel legjislativ për viktimat e trafikimit, ndërkohë që mund të ketë nevojë për një ligjtëveçantveçantë përse i përket mbrojtjes së viktimave, fëmijëve tyre dhe parandalimit të fenomenit tëtrafikimit, punës skllavëruese e lypjessë detyruar, mbrojtjessë viktimave jashtë procedimit penaledhe në rastet kur ato nuk bashkëpunojnë me organet e zbatimit të ligjit, dhënies sëstatusit viktimë apo viktimë e mundshme e trafikimit, referimit, riintegrimi, kompensimit të tyre nëpërmjet një instrumenti ligjor efikas, si një mekanizëm kompensimi në mënyrë të drejtpërdrejtë, si dhe rritjes së garancive të respektimit të të drejtave të garantuara nga legjislacioni procedural gjatë fazës së hetimit apo gjykimit të veprave penale të trafikimit.

Paraprakisht po përmendim konstatimin se megjithë ndërhyrjet e fundit ne legjislacionin procedural penal, përsëri çështja e kompensimit të viktimave të trafikimit mbetet një standard i munguar pasi si instrumenti i padisë civile në procesin penal, ashtu dhe kompensimi sipas skemës shtetërorë të parashikuar nga ligji antimafia, përsëri kompensimi i viktimave të trafikimit mbetet një e drejtë e papërbushur në mënyrë të drejtëpërdrejtë.

Si konkluzione paraprake po eidentojmë faktin që standardet e trajtimit të viktimave të trafikimit si dhe elementë garantues të mbrojtjes i kemi të shpërndara në disa nivele të akteve ndërkombëtare, niveli kushtetues, Kodi Penal dhe Kodi i Procedurës Penale, si dhe të ligjeve të veçanta dhe akteve nënligjore.

Duke qenë vend anëtar i OKB-së dhe Këshillit të Europës, Konventat janë pjesë e brendshme e legjislacionit tonë dhe këtu do të veçojmë;

1. Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të OrganizuarNdërkombëtar, Protokollit i Palermos<sup>4</sup>, i cili përfshin definicionin kryesor të njohur ndërkombëtarisht për trafikimin. Protokollit i Palermos përmban dy protokollet e saj plotësuese :
  - Protokollit Kundër Kontrabandimit të Migrantëve në Rrugë Tokësore, Ajrorë dhe Detare.
  - Protokollit mbi Parandalimin, Pengimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të Personave, Veçanërisht të Grave dhe Fëmijëve.

---

<sup>4</sup>Kjo Konventë dhe dy protokollet e saj janë ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 8920 datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e Konventës së OKB Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar“ dhe dy protokolleve shtesë tësaj.



2. Konventa e Këshillit të Evropës për masa kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Konventa e Varshavës<sup>5</sup>.

Gjithashtu ne kuadër të OSBE është miratuar një Plan - Veprimi për Luftimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore<sup>6</sup> që ka të bëjë me mbrojtjen e viktimave, mos-penalizimin e personave të trafikuar për vepra penale të lidhura me trafikimin, *ngritjen e Mekanizmave Kombëtarë të Referimit dhe hartimin e Udhëzuesve për identifikimin e saktë, informimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, mbrojtjen, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijëve të trafikuar*. Një mekanizëm i tillë zbatues tek ne është i parashikuar në nivelin e një akti nënligjor që ka të bëjë me miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit<sup>7</sup> Dhe së fundi edhe Plani Kommbëtar i Veprimit kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore 2018-2020<sup>8</sup>.

E drejta europiane ka zhvilluar më tej standardin e trajtimit të viktimave të trafikimit, mbrotjes e parandalimit me një sërë aktesh si Vendimet e KE, Direktivat, Rekomandimet etj. Jurisprudenca e GJEDNJ nga ana tjetër çdo ditësygjeron legjislacioneve vendase të KE përmbushjen e detyrimeve pozitive e negativepër mbrotjen e viktimave te trafikimit. Garancitë bazë dhe fryma e disa prej këtyre akteve është reflektuar në ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale me ligjin nr. 35/2017.Megjithatë ka nevojë për plotësime me norma të tjera për përmbushjen e standardeve të kërkuara nga aktet ndërkombëtare.

Legjislacioni penal dhe procedural garanton mbrotjen gjatë procesit gjyësor, por është sistemi i ligjeve referuese që plotëson aspektin e munguar legjislativ sidomos për mbrojtjen, parandalimin jashtëprocedimit penal dhe kompensimin.

Në Shqipëri mungon një autoritet koordinues dhe monitorues i veprimeve të institucioneve shtetërore dhe organizatave që asistojnë viktimat apo advokojnë për të drejtat e tyre, autoritet i cili deri në vitin 2017 ushtrohej nga Zëvendëministri i Brendshëm sipas fushës së përgjegjësisë të Ministrisë së Brendshme.

---

<sup>5</sup>Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore, e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006

<sup>6</sup> Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 557, PC.DEC/557, 24 Korrik 2003, shtojca e Planit - Vendim i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së nr. 685, PC.DEC/685, 7 Korrik 2005.

<sup>7</sup>Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe plani i veprimit 2014 – 2017, VKM nr. 663 datë 17.07.2013 dhe VKM nr. 814 datë 26.11.2014.

<sup>8</sup>VKM Nr. 770, datë 26.12.2018 pwr miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore

## METODOLOGJIA

Për kryerjen e kësaj analize mbi nevojat për një ligj të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, fillimisht u bë studimi i të gjitha akteve ligjore e nënligjore në fushën e identifikimit, mbrojtjes, rehabilitimit dhe riintegrit të viktimave, si dhe në fushën e ndjekjes penale.

Gjithashtu me qëllim marrjen e praktikave më të mira ndërkombëtare ku ekzistojnë ligje të veçanta për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, u shqyrtua akti i mbrojtjes së viktimave të trafikimit (i ndryshuar) i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Akti për Skllavërinë Moderne i Mbretërisë së Bashkuar dhe Ligji për Parandalimin dhe luftimin e trafikimit të personave në Kosovë.

Gjetjet e këtij raporti u diskutuan në të tre takimet e organizuara me grupin ad-hoc për vlerësimin e nevojës për hartimin e një ligji të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Ky grup është ngritur na zbatim të , Vendimin nr. 770, datë 26.12.2018 të Këshillit të Ministrave“Për Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën Kundër Trafikimit të Personave 2018-2020”,i cili për realizimin e synimit të parë strategjik që lidhet me ndjekjen penale, në pikën 1(a)6 parashikon *“ngritjen e një grupi ad hoc për kryerjen e një analize dhe vlerësimi të thelluar mbi nevojën për një ligj të vecantë me fokus mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit”*.<sup>9</sup>.

---

<sup>9</sup> Ndjekja Penale; aktiviteti 1(a)6; VKM Nr. 770, datë 26.12.2018; “Pwr miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018-2020”

## KOORDINIMI

Ministria e Brendshme, nëpërmjet Zëvendësministrit të Brendshëm, prej vitit 2005 ka luajtur një ndër rolet më të rëndësishme, atë të Koordinatorit Kombëtar të përpjekjeve antitrafik në rang vendi. Përpjekjet për të koordinuar punën midis institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile janë materializuar edhe me Marrëveshjen e Bashkëpunimit për funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR)<sup>10</sup> për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit. Marrëveshja përcakton qartësisht detyrat e secilës palë sipas fushës së përgjegjësië për ndërhyrjen në funksion të identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit. Në nenin 7 të marrëveshjes, ku përcaktohet roli i Autoritetit Përgjegjës si struktura që udhëheq zbatimin e marrëveshjes si dhe në nenin 8 “Monitorimi dhe bashkërendimi i marrëveshjes” referohet Koordinatori Kombëtar si institucioni ku raportohet periodikisht në lidhje me mbarëvajtjen e saj si dhe roli i Njësisë Antitrafik si sekretariati teknik i Task Forcës që monitoron këtë marrëveshje.

Pavarësisht parashikimeve të mësipërme, në legjislacionin shqiptar mungon përcaktimi i një autoriteti koordinues, Koordinator Kombëtar që aktualisht ushtrohet nga Zëvendësiministri i Brendshëm. Në pikën III, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 942, datë 9.10.2013<sup>11</sup>, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme”, ishte përcaktuar si fushë e përgjegjësisë monitorimi dhe bashkëpunimi me institucionet e ngarkuara për zbatimin e masave në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke e ngarkuar Ministrinë e Brendshme me koordinimin në këtë fushë. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 502, datë 13.9.2017 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, vendim i cili ka shfuqizuar vendimin e sipërcituar nuk ka përcaktuar si fushë përgjegjësie monitorimin dhe koordinimin në kuadër të trafikimit të qenieve njerëzore.

Gjithashtu, me ndryshimet në legjislacion, Njësia Antitrafik funksionet e të cilës përcaktoheshin në urdhrin nr. 203 datë 19.12.2005 “Për funksionimin e Njësisë Antitrafik”, nuk ekziston më për shkak të ndryshimeve strukturore dhe fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme në vite.

---

<sup>10</sup> Marrëveshje Bashkëpunimi për funksionimin e MKR për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit të personave [http://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/mkr\\_shqip.pdf](http://mb.gov.al/wp-content/uploads/2018/01/mkr_shqip.pdf)

<sup>11</sup>VKM nr. 942 datë 09.10.2013 “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Punëve të Brendshme”<https://mb.gov.al/vendim-nr-942-date-9-10-2013-per-percaktimin-e-fushes-se-pergjegjesise-shtetere-te-ministrise-se-puneve-te-brendshme/>

Zyrës e Koordinatorit Kombëtar në ndërmarrjen e iniciativave të ndryshme në fushën e parandalimit dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit do të duhej të ishte një njësi shpenzuese në vete, të kishte të përcaktuara qartë përbërjen dhe detyrat funksionale të kësaj strukture, por sot një gjë e tillë është e pamundur për shkak edhe të organizimit strukturor të Ministrisë së Brendshme, i cili nuk e parashikon as në fushën e përgjegjësisë. Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në pikën 5 të nenit<sup>3</sup> përkufizon: *“Njësi të qeverisjes qendrore” janë njësitë e pushtetit ekzekutiv, legjislativ dhe gjyqësor, të krijuara me Kushtetutë, ligj ose vendim të Këshillit të Ministrave, që kanë si veprimtari të tyre parësore përmbushjen e funksioneve të qeverisjes qendrore”*.

Sikurse e diskutuam më lart Koordinatori Kombëtar nuk është një njësi e krijuar me ligj apo vendim të Këshillit të Ministrave dhe si rrjedhim nuk mund t’i atribohet një buxhet i veçantë.

Vendimi nr. 150/2019 datë 20.3.2019, ”Për metodologjinë e llogaritjes së fondeve për financimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror”, ka përcaktuar metodologjinë e financimit nga buxheti qëndror, në mënyrë të vazhdueshme për shërbimet e reja në nivel vendor, e cila mund të përmbushë më së miri funksionet e përcaktuar në këtë ligj, pra të përmbushë funksionet e qeverisjes vendore të dedikuara për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

Nevoja për të përcaktuar autoritetin koordinues, Koordinatorin Kombëtar, detyrat funksionale të tij, buxhetin e dedikuar duhet të parashikohet në ligj, duke përfshirë këtu dhe raportimin në lidhje me masat e marra nga qeveria Shqiptare në kuadër të luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjes së viktimave. Një përcaktim i tillë në ligj do të rriste efikasitetin dhe bashkëpunimin e të gjitha institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile, gjithashtu do të lehtësonte dhe përmirësonte të gjitha hapat në funksion të luftës kundër fenomenit dhe mbrojtjes së viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, i ngritur me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.8, datë 5.1.2002, të ndryshuar, drejtohet nga Ministri i Brendshëm, përbëhet nga përfaqësues politik të niveleve të ndryshme, është përgjegjës për zbatimin e angazhimeve të Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore si dhe zbaton urdhrat dhe udhëzimet e Ministrisë së Brendshme, njëkohësisht edhe Kryetar i Komitetit Shtetëror kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Komiteti vlerëson nivelin e zbatimit të Strategjisë, propozon dhe merr masat e mëtejshme për arritjen e objektivave të

Strategjisë. Duke iu referuar funksioneve të përcaktuara, Komiteti jo vetëm harton politika në këtë fushë, por edhe monitoron dhe i zbaton ato. Dukshëm ekziston një konflikt interesi midis Ministrisë së Brendshme si institucion dhe Kryetarit të Komitetit Shtetëror i cili është Ministri i Brendshëm.

## MBROJTJA

Legjislacioni shqiptar parashikon në akte të ndryshme çështjet e mbrojtjes së viktimave të trafikimit. Ndihamat për viktimat duhet të përcaktohen, si dhe të jenë konkrete. Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, përcakton detyrimin e palëve për miratimin e masave legislative ose masave të tjera sipas nevojës, për të ndihmuar viktimat në rikuperimin e tyre fizik, psikologjik dhe shoqëror. **Në rehabilitimin e këtyre viktimave duhet të përcaktohet mundësia e përfitimit të programeve të mbrojtjes, të nxitjes së punësimit, të arsimit profesional, etj (masa konkrete të përcaktuara në ligj).**

Viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit janë përcaktuar si kategori e veçantë, punëkërkues të disavantazuar në tregun e punës, e ligjit nr.15/2019 “Për nxitjen e punësimit”. Pavarësisht se janë një kategori e veçantë e ligjit, ende nuk janë përcaktuar programet konkrete për to. Sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 11 të ligjit “Programet e nxitjes së punësimit zbatohen dhe administrohen nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, në bashkëpunim me institucione të tjera publike, përgjegjëse për zhvillimin ekonomik e kualifikimin, si dhe në bashkëpunim me sektorin privat dhe organizata të shoqërisë civile”.

Ligji nr.65/2016 “Për ndërmarrjet sociale”, ka si qëllim të rregullojë veprimtarinë e ndërmarrjeve sociale, me qëllim mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të grupeve vulnerabël të cilët nuk kanë një përcaktim në këtë ligj. Në germën (k), të pikës 2, të vendimit nr. 56, datë 31.01.2018 “Për përcaktimin e kategorive konkrete të grupeve të pafavorizuara”, “*gratë dhe vajzat viktimë/viktima të mundshme të trafikimit, të shfrytëzimit dhe të dhunës në familje*” ” janë e vetmja kategori përfituese, duke përjashtuar e diskriminuar djemtë/burratsi viktimë apo viktimë të mundshme të trafikimit.

Në ndryshim nga viktimat e dhunës në marrdhëniet familjare të cilat përfitojnë ndihmën ekonomike për “*..periudhën e vlefshmërisë së urdhrit të mbrojtjes ose të urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes, që nuk trajtohen në institucionet e përkujdesjes shoqërore*”<sup>12</sup>, për viktimat e trafikimit kjo ndihmë jepet “*pas daljes nga institucionet e përkujdesjes shoqërore, deri në çastin e punësimit të tyre*”. Mungon një përcaktim ligjor në lidhje me trajtimin për periudhën në institucionet e përkujdesjes shoqërore, sikurse nuk parashikohet ky trajtim në rast se viktimat nuk marrin trajtim në qendër por i përfitojnë shërbimet e përkujdesjes në komunitet.

---

<sup>12</sup>Neni 5 I ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”

Vendimi nr.707, datë 26.8.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar i ka përacktuar fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë të identifikuar si viktimë/viktima të mundshme trafikimi si kategori që përfitojnë financimin 100% nga MASR e librave shkollorë. Në asnjë pikë të këtij vendimi nuk janë identifikuar si kategori fëmijët e viktimave të trafikimit apo ato viktimë të cilat do të duhet të arsimohen por që mosha e tyre nuk përkon me ata të arsimit bazë të detyrueshëm.

*“6.9. Çmimi i blerjes së teksteve shkollore të arsimit bazë mbulohet në masën 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit:*

*a) Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, viktimë të trafikimit, të cilëve u ofrohet ndihmë dhe asistencë nga Qendra Kombëtare e Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendra Kombëtare e Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencës, sipas kërkesës zyrtare për sasinë e teksteve shkollore të nevojshme.*

*Për fëmijët e moshës shkollore të arsimit bazë, që gëzojnë statusin e viktimës/viktimës së mundshme të trafikimit në përputhje me vendiminnr. 582, datë 27.7.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për identifikimin dhe referimin e viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit”.*

Një problematikë tjetër e identifikuar është edhe pika 6.11 e këtij vendimi ku përcaktohet mënyra sesi do të procedohet duke e lidhur gëzimin e kësaj të drejte me marrjen e asistencës në një institucion rezidencial publik të përkujdesjes sociale. *“Për tekstet shkollore të fëmijëve nga klasa I deri IX, të cilët janë përfitues në institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike, në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Viktimave të Trafikimit, Qendrën Kombëtare të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencës, çmimi i blerjes së tyre të mbulohet 100% nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Drejtoritë përkatëse të shkollave, ku mësojnë nxënës, duhet të bashkërendojnë punën me drejtoritë e institucioneve të sipërpërmendura dhe të dorëzojnë në drejtoritë arsimore rajonale/zyrat arsimore përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, listën e nxënësve të kësaj kategorie. Mënyra e shpërndarjes së teksteve për këtë kategori nxënësish përcaktohet me udhëzim të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.”*<sup>13</sup>

---

<sup>13</sup>Vendim nr.707, datë 26.8.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar

Ligji nr.141/2014 “Për disa shtesa në ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ka përcaktuar si kategori që mbulohen nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor,: “*viktimat e trafikimit, sipas identifikimit të bërë nga strukturat e Ministrisë së Brendshme*”<sup>14</sup>, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të përcaktuara me ligj. Sikurse shihet edhe në këtë ligj mbulimi është i kufizuar vetëm për kategorinë e viktimave të trafikimit duke mos përfshirë viktimat e mundshme të trafikimit por edhe duke mos dhënë përcaktimin e saktë për mënyrën e identifikimit të tyre.

Procedurat Standarde të Veprimit për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit parashikojnë mënyrën dhe autoritetet përgjegjëse për identifikimin fillestar dhe atë formal të viktimave të trafikimit, proces i cili shënon edhe fillimin e përfitimit të shërbimeve të asistencës dhe mbrojtjes së tyre. Duke qenë se këto autoritete janë vendimmarrëse si rrjedhim aktet administrative që nxjerrin janë të kundërshtueshme.

Pika 22 dhe 23 e vendimit Nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar” janë në kundërshtim me VKM Nr. 499 datë 29.8.2018 “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”, për faktin se referimi në një qendër i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit bëhet menjëherë duke pasur parasysh interesin më të lartë të viktimave apo viktimave të mundshme të trafikimit. Pikat 22 dhe 23 e vendimit nr. 518 përcakton procedurën për referimin në një qendër rezidenciale duke vendosur edhe një afat për miratimin e kërkesës, procedurë e cila nuk duhet të ndiqet për këtë kategori, duke pasur parasysh edhe referencat ligjore.

*“22. Bashkërendimi i mbështetjes dhe referimi të shërbimet e kujdesit social në nivel vendor, rajonal dhe qendror. Për shërbimet në nivel rajonal dhe qendror vendimi për referimin merret bashkërisht me SHSSH-në.*

*23.Me përjashtim të viktimave të dhunës në familje, viktimave të trafikimit dhe të mundshme të trafikimit, për individët dhe familjet në nevojë, vendimi për t’i ofruar shërbimin e kërkuar merret brenda një muaji nga data e kërkesës nga:*

---

<sup>14</sup>Neni 1, Ligj nr.141/2014 për disa shtesa në ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar



a) *Këshilli i Bashkisë, në rastin kur shërbimi i kërkuar funksionon në territorin e bashkisë respektive ku banon individi apo familja në nevojë mbi bazën e propozimit të strukturës përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shoqëror pranë bashkisë;*

b) *Këshilli i Qarkut, në rastin kur shërbimi i kërkuar përfshihet në territorin e qarkut ku banon kërkuesi i shërbimit, mbi bazën e propozimit të ardhur nga Këshilli i Bashkisë që përfshihet në territorin e qarkut;*

c) *Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror, në rastet kur në territorin e bashkisë dhe qarkut ku banon kërkuesi i shërbimit nuk ka shërbim rezidencial për nevojat e individit.*<sup>15</sup>

Shërbimet për viktimat ofrohen si për ato shqiptare ashtu edhe të huajat, të cilave unjitet e drejta për tu pajisur edhe me leje qëndrimi si kategori e veçantë e ligjit nr.74\_2016 “Për të huajt”. Ky ligj është përafuar me Direktivën e Këshillit 2004/81/KE, datë 29 prill 2004 “Mbi lejet e qëndrimit të lëshuara shtetasve të vendeve të treta që janë viktime të trafikimit të qenieve njerëzore ose që kanë qenë subjekt i një veprimi për lehtësimin e imigracionit të paligjshëm, të cilët bashkëpunojnë me autoritetet kompetente”, dhe në nenin 54 është përcaktuar lëshimi i lejes së qëndrimit për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, të huajin viktimë e trafikimit në Republikën e Shqipërisë, “*pavarësisht nga vullneti i tij/saj për të bashkëpunuar me drejtësinë, kur ka shkaqe të arsyeshme për të besuar se i huaji është viktimë ose viktimë e mundshme e trafikimit, e identifikuar si e tillë nga strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit.*

*Kjo leje qëndrimi i jepet viktimës ose viktimës së mundshme të trafikimit me qëllim që të rimarrë veten, si dhe të trajtohet sipas gjendjes fizike dhe mendore për marrjen e një vendimi të mirinformuar për të bashkëpunuar ose jo me organet e drejtësisë, identifikuar si të tillë nga strukturat përgjegjëse për identifikimin dhe referimin e viktimave të trafikimit, në njërin ose tjetrën prej dy situatave të mëposhtme ose në të dyja këto situata:*

a) *vlerëson se qëndrimi i saj/tij është i nevojshëm për shkak të situatës sociale dhe personale;*

b) *vlerëson se qëndrimi i saj/tij është i nevojshëm për qëllim të bashkëpunimit me organet e drejtësisë gjatë hetimit ose procedimit penal;*

---

<sup>15</sup> Vendimi Nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”

*Gjatë periudhës së rikuperimit dhe reflektimit, viktimat ose viktimat e mundshme të trafikimit gëzojnë të gjitha të drejtat dhe shërbimet që përfitojnë viktimat e trafikimit, sipas legjislacionit shqiptar në fuqi”.*

Në të gjitha rastet e mësipërme, viktimat e trafikimit apo viktimat e mundshme të trafikimit, përcaktohen sipas akt vlerësimit të bërë nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, kompetencat e të cilave duhet të jenë të përcaktuara në ligj, si dhe të përcaktohen aktet që kanë të drejtë të nxjerrin për të unifikuar procedurën, me qëllim arritjen e një vendimmarrje të drejtë nga autoriteti përgjegjës për lëshimin e lejes së qëndrimit.

DH kundër Finlandës (nr.30815 / 09) 28 qershor 2011 (vendimi i grevës)

*Paditësi, një shtetas somalez, i lindur në 1992, arriti me anije në Itali në nëntor 2007. Ai po largohej nga Mogadishu ku pretendonte se ishte detyruar të bashkohej me ushtrinë pas rënies së strukturave administrative të vendit dhe ku ai rrezikoi jetën e tij në duart e trupave etiopiane që synonin kapjen dhe vrasjen e ushtarëve të rinj somalezë. Autoritetet italiane e lanë atë në rrugët e Romës në dimrin e vitit 2007, pa asnjë ndihmë apo burime. Ai ishte vazhdimisht i uritur dhe në të ftohtë, i abuzuar fizikisht dhe verbalisht në rrugë, dhe nga policia në Milano, ku ai kërkonte ndihmë. Përfundimisht, **ai u trafikua në Finlandë, ku kërkoi azil, por që iu refuzua në shkurt të vitit 2010.** Aplikuesi u ankua se nëse kthehet në Itali, ai do të rrezikonte trajtim çnjerëzor ose degradues në kundërshtim me nenin 3 të Konventës, veçanërisht pasi ai ishte një i mitur i pashoqëruar.*

*Gjykata e zbatoi kërkesën nga lista e saj e rasteve, në përputhje me Neni 37 (nxjerrja e kërkesave) të Konventës, siç vuri në dukje se **paditësit i është dhënë një leje qëndrimi e vazhdueshme në Finlandë dhe se ai nuk ishte më subjekt i një urdhër dëbimi.** Gjykata konsideroi kështu se çështja duhet të ishte zgjidhur në favor të subjektit ankimues.*

OGO kundër Britanisë së Madhe (nr.1395/12), 18 shkurt 2014 (hedh poshte vendimin)

*Paditësja, shtetase Nigeriane, e cili pretendonte të ishte viktimë trafikimi, u ankua se dëbimi i saj në Nigeri do ta ekspozonte në një rrezik real të ri-trafikimit. Gjykata vendosi të shtyjë kërkesën nga lista e saj e rasteve, në përputhje me nenin 37 (shtyrja e kërkesave) të Konventës, duke vënë në dukje se paditësi nuk ishte më në rrezik të hiqej pasi asaj i ishte*

*dhënë statusi i refugjatit dhe leje të pacaktuar për të qëndruar në Mbretërinë e Bashkuar.  
Për më tepër, autoritetet Britanike kishin pranuar se ajo kishte qenë viktimë trafikimi.*

Fragmentimi i të drejtave të viktimave apo masave që duhet të ndërmerren në funksion të luftës ndaj fenomenit por edhe mbrojtjes së viktimave, sjell jo në pak raste shërbime të munguara, vështirësi në interpretimin e të drejtave dhe detyrimeve të institucioneve shtetërore ndaj tyre.

**Sa më sipër, propozimi i një ligji të veçantë do të ishte instrumenti i duhur ligjor, ku të përcaktohej si detyrimi për të identifikuar viktimat e mundshme dhe viktimat e trafikimit, ku më pas do të mbështetej edhe hartimi i procedurave standarde të veprimit, do të duhet të përcaktojë edhe autoritetin përgjegjës në shkallë të dytë për ankiminin administrativ të grupeve që kryejnë identifikimin fillestar dhe atë formal. Po ashtu ky ligj duhet të përcaktojë nëse duhet të ketë një autoritet në shkallë të dytë për ankiminin administrativ apo ankim direkt në gjykatë. Afati i ankimit në gjykatën kompetente duhet të përcaktohet në ligj. Afatet duhet të përcaktohen në analizë të afateve procedurale që nga momenti i ankimit administrativ dhe gjyqësor, pra në harmoni me Kodin e Procedurave Administrative. Ligji gjithashtu duhet të përcaktojë efektet që passjell akti administrativ i identifikimit fillestar dhe atij formal.**

Një mungesë tjetër e evidentuar është edhe mosparashikimi i ngritjes dhe funksionimit të “Databazës për viktimat e trafikimit” nga autoriteti përgjegjës më qëllim menaxhimin më të mirë të rasteve dhe analizimit të trendit të trafikimit në vend.

## PARANDALIMI

Me ligjin nr. 9644, datë 20.12.2006 u ratifikua Konventa e Këshillit të Evropës, “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, e cila përcakton detyrimin e palëve për të marrë masa për të përcaktuar ose forcuar koordinimin kombëtar midis organeve të ndryshme përgjegjëse për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke parashikuar edhe disa masa konkrete në këtë fushë, që vijnë si detyrime për palët:

- Të vendosë dhe/ose forcojë politikën dhe programet efektive, për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore me anë të mënyrave të tilla si: kërkimi, informacioni, ndërgjegjësimi dhe fushatat arsimore, nismat shoqërore e ekonomike dhe programe të trajnimit, veçanërisht për personat e ndjeshëm ndaj trafikimit dhe për profesionistë të interesuar mbi çështjen e trafikimit të qenieve njerëzore;
- të nxisë përqasjen e bazuar në të drejtat e njeriut dhe të përdorë çdo përqasjet tjetër gjinore që lidhet ngushtë me fëmijët, në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e politikave dhe programeve;
- të marrë masa të duhura, sipas nevojës, për të siguruar migrimin që të bëhet në mënyrë të ligjshme, veçanërisht nëpërmjet bërjes publike të informacionit të saktë nga zyrtarët përkatës, mbi kushtet që mundësojnë hyrjen e ligjshme dhe qëndrimin në territorin e vet.

Gjithashtu Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të 5 prillit 2011, “Mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrotjen e viktimave, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA” në nenin 18 të saj përcakton masa të duhura të marrin shtetet anëtare në lidhje me parandalimin e çdo formë trafikimit të personave, që prej reduktimit të kërkesave që çojnë në shfrytëzim apo përdorimit të internetit si një mjet i ri tashmë për rekrutimin e viktimave të trafikimit. Në funksion të adresimit të kërkesës, në Kodin Penal Shqiptar me ligjin nr 144 datë 02.05.2013, u shtua një dispozitë e re në nenin 110/b që kriminalizon kërkesën për shërbime të ofruara nga viktimat e trafikimit.

**Neni 110/b ”Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar”** parashikon se:

*Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet*

*me burgim nga dy deri në pesë vjet.*

*Kur kjo vepër kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.*

Edhe Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftën kundërdhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, e ratifikuar nga Shqipëria, në nenin 11 të saj, përcakton se palët duhet të marrin masat e nevojshme legislative dhe masa të tjera për të parandaluar të gjitha format e dhunës të mbuluara nga objekti i kësaj Konvente nga çdo person fizik ose juridik.

Të dyja këto konventa, sikurse edhe Direktiva 2011/36, kërkojnë që masat për parandalimin e trafikimit dhe dhunës, të përcaktohen në ligj dhe të ndërmerren sipasnevojës, me organizatat joqeveritare, organizatat e tjera të ngjashme dhe elemente të tjera të shoqërisë civile, të angazhuar në parandalimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

Edhe Gjykata Europiane për të drejtat e Njeriut në vendimet e saj ka sjellë në vemendje detyrimin e shteteve për të marrë masa për parandalimin e trafikimit e ndëshkimin e autorëve të tij.

Chowdury dhe të tjerët kundër Greqisë (30 Mars 2017)

*Paditësit - 42 shtetas nga Bangladeshi - u rekrutuan në Athinë dhe në pjesë të tjera të Greqisë nga fundi i vitit 2012 deri në fillim të vitit 2013, pa leje pune greke, për të punuar nëfermën kryesore të luleshtrydheve në Manolada. Punëdhënësit e tyre nuk arritën të paguajnë tarifatat e paditësve, pagat dhe i detyroi të punonin në kushte të vështira fizike nën mbikëqyrjen e rojeve të armatosura. Paditësit pretendonin se i ishin nënshtruar dhunës apo punës së detyrueshme. Ata më tej pohuan se shteti ishte nën detyrimin për t'i parandaluar ata të jenë subjekt i trafikimit të qenieve njerëzore, të miratonin masa parandaluese për këtë arsye dhe për të ndëshkuar punëdhënësit.*

*Gjykata u shpreh se kishte shkelje të nenit 4/2 të Konventës (ndalimi i dhunës dhe punës së detyruar), duke gjetur se paditësit nuk kishin marrë mbrojtje nga shteti grek. Gjykata vuri në dukje, faktin se në veçanti, situata ishte nga trafikimi i qenieve njerëzore dhe puna e detyruar, dhe specifikonte shfrytëzimin përmes punës si aspekt i trafikimit të qenieve njerëzore. Gjykata gjeti gjithashtu se shteti kishte dështuar në detyrimet e tij për të*

**parandaluar situatën e trafikimit të qenieve njerëzore në mbrojtje të viktimave, të kryente hetim efektiv për veprat e kryera dhe për të ndëshkuar ata që janë përgjegjës për trafikimin.**

Duke iu referuar sa më sipër, pavarësisht detyrimeve të përcaktuara nga Konventat, praktikave gjyqësore, etj. në legjislacionin shqiptar mungojnë masat konkrete legjislative për të parandaluar trafikimin e qenieve njerëzore nga ku do të derivonin edhe masat dhe aktivitete parandaluese që i gjejmë në Strategji apo Plane Veprimi.

Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”<sup>16</sup>, në nenin 37 përcakton krijimin e fondit të posaçëm për parandalimin e kriminalitetit. Në pikën 2 të këtij neni thuhet shprehimisht: - 2. *Ky fond shërben për: a) përmirësimin e funksionimit të drejtësisë penale, duke destinuar pasuritë në administrim të Prokurorisë së Përgjithshme, Prokurorisë së Posaçme dhe të Ministrisë së Drejtësisë; b) përmirësimin e hetimeve paraprake penale të krimit të organizuar dhe zhvillimin e programeve të mbrojtjes së dëshmitarëve e të bashkëpunëtorëve të drejtësisë, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet e rendit publik; c) dhënien e ndihmës viktimave të krimit të organizuar, si dhe nxitjen e programeve sociale për këto kategori, duke destinuar pasuritë në administrim të ministrisë që mbulon çështjet sociale. ç) dëmshpërblimin e viktimave të krimit të organizuar dhe të trafikimit në masën e përcaktuar me vendim gjyqësor.* Megjithë vullnetin e mirë të shprehur edhe në ligj, sërish mungon qartësimi në legjislacion për zbatimin e kësaj dispozite ashtu si dhe mungon mekanizmi i aplikimit në mënyrë të drejtpërdrejtë i dëmshpërblimit të viktimave nëpërmjet këtij fondi.

<sup>16</sup>Ligji Nr. 10192, datë 3.12.2019 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” (ndryshuar me ligjin nr. 24/2014, datë 20.3.2014, nr. 70/2017, datë 27.4.2017)

## NDJEKJA PENALE

### **Ndryshimet në legjislacionin tonë penal dhe procedural.**

Legjislacioni penal dhe ai procedural kanë ndryshuar në drejtim të adaptimit të “viktimologjisë” si koncept. Me ndryshimet në legjislacionin penal në vitin 2013<sup>17</sup>, në nenin 52/a të KP, është përfshirë për herë të parë termi “*viktima*“, duke u parashikuar përjashtimi ose ulja e dënimit për viktimat e trafikimit sipas së cilës, personat e dëmtuar nga vepra penale që lidhen me trafikimin e personit, mund të përfitojnë përjashtimin nga dënimi, për kryerjen e veprave penale gjatë periudhës së trafikimit dhe në masën që ato kanë qenë të detyruar ti kryejë ato veprime apo mosveprime të kundërligjshme.

Kodi Penal me ndryshimet e vitit 2013<sup>18</sup> ka bërë ndërhyrje të rëndësishme në raport me mbrojtjen e viktimës nga vepra penale si në rastet e vrasjeve ndaj personit, krimeve seksuale, ashtu dhe ndaj veprave penale të trafikimit. Kështu përsa i përket rrethit të personave të cilët gëzojnë mbrojtje Kodi Penal ka përfshirë dhe bashkëjetuesin apo ish-bashkëjetuesin, ndërsa tek krimet seksuale sigurojnë mbrojtje më të madhe për dinjitetin e personit ndaj veprimeve kërcenuese, degraduese apo ofenduese që mund të përbëjnë ngacmim seksual. Ndërsa neni 110 mbi trafikimin e personave përfshin tashmë dhe trafikimin brenda territorit të vendit, një koncept ky i njohur nga Konventa e Këshillit të Europës kundër trafikimit.

Legjislacioni procedural shqiptar ka ndryshuar<sup>19</sup> dhe tashmë viktima e trafikimit është subjekt procedural me të drejta procedurale të caktuara ndaj së cilës organet proceduese duhet të përmbushin një sërë detyrimesh. Kodi i Procedurës Penale ka sanksionuar detyrimin pozitiv të organeve publike që të garantojnë që viktimat e veprës penale të trajtohen me respekt për dinjitetin e tyre njerëzor dhe të mbrohen nga ridëmtimi, gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre<sup>20</sup>. Është parashikuar detyrimi për pjesëmarrjen si palë në proces të viktimës së veprës penale, duke garantuar aksesin e saj në procesin penal në referim të përcaktimit të Vendimit Kuadër të BE-së mbi statusin e viktimave në gjykimin penal të datës 15/03/2001.

---

<sup>17</sup> Ligji nr. 144/2013 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7895 datë 27.01.1995 “Kodi Penal i RSH”.

<sup>18</sup> Ligji nr.144 /2013 ‘Për disa ndryshime në ligjin nr.7895 , datë 27.01.1995 ‘Kodi Penal i RSH’, të ndryshuar.

<sup>19</sup>U referohemi ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 35/2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 Kodi i Procedurës Penale i RSH“

<sup>20</sup> Neni 9/a i KPrP”Të drejtat e viktimës nga vepra penale”

Tashmë është zëvendësuar figura e "të dëmtuarit nga vepra penale" me termin "viktimë" dhe atë të "të dëmtuarit akuzues" me termin "viktima akuzuese", duke dhënë edhe përkufizimet e rregullimet përkatëse për këto subjekte në përputhje me Vendimin Kuadër të 15 marsit 2001 mbi qëndrimin e viktimave në procedimet penale, si dhe Direktivën 2012/29 /BE që e ka zëvendësuar këtë vendim.

- Neni 58 është riformuluar tërësisht<sup>21</sup> dhe pas tij janë shtuar nenet 58/a dhe 58/b, në të cilin janë parashikuar si figura të posaçme *viktima e mitur* dhe *viktima e abuzuar seksualisht* apo *subjekt i trafikimit*<sup>22</sup>. Në këto dy raste është parashikuar që viktima të ketë edhe disa të drejta të posaçme që lidhen me vetë cilësitë e saj të veçanta;
- Është shtuar neni 59/a, i cili parashikon rastin e viktimave të shumta nga vepra penale, me qëllim shmangien e zvarritjes së procesit për këtë shkak, duke garantuar perfaqësimin e tyre nga i njëjti mbrojtës në rastet kur nuk ka pengesë;
- Në nenin 60 është parashikuar në mënyrë të detajuar permbajtja e kërkesës së viktimës akuzuese, me qëllim mundësimin e zhvillimit të një procesi gjyqësor normal;
- Gjithashtu, është parashikuar se padinë civile në procesin penal mund ta ngreje vetëm viktima ose trashëgimtarët e saj.

Ky pozicionim i ri i viktimës dhe kapaciteti i të drejtave procedurale efektive të tyre në legjislacionin tonë procedural vjen si detyrim i zbatimit të Konventave të OKB<sup>23</sup> dhe Këshillit të Europës<sup>24</sup> në të cilat ne kemi aderuar si vend e që janë pjesë e legjislacionit të brendshëm, cituar më sipër në këtë studim, por edhe në njohje e duke i paraprirë adaptimit të legjislacionit european nën frymën e akteve të tjera kuadër të BE-së.

### **Standardet ndërkombëtare në lidhje me trajtimin e veprave penale të trafikimit dhe trajtimin e viktimës.**

Standardet ndërkombëtare përmbajnë detyrime për respektimin e viktimave të trafikimit duke u ndalur tek të miturit në veçanti dhe kërkojnë që gjatë ndjekjes penale të këtyre veprave penale

<sup>21</sup>Neni 58 i KPrP i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017

<sup>22</sup>Vec të drejtave të parashikuara

<sup>23</sup>Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar dhe dy protokollet shtesë të saj, të ratifikuara me ligjin nr. 8920 datë 11.07.2002.

<sup>24</sup>Konventa e Këshillit të Europës "Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore", e ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006.



viktimat të mbrohen e të trajtohen në përputhje me parimet e humane, të mbrojtjes e garantimit të jetës, shëndetit e personalitetit me qëllim rehabilitimin e tyre.

Standardet ndërkombëtare përbëhen nga norma ndërkombëtare në nivelin e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, norma ndërkombëtare të Këshillit të Europës dhe norma ndërkombëtare në nivelin e BE si Vendimet Kuadër, Direktivat dhe Rekomandimet. Këto të fundit nuk janë të detyrueshme por janë të rekomandueshme pasi përcjellin frymen e legjislacionit europian ku dhe ne do aderojmë në të ardhmen e afërt. Përveç dy akteve juridike ndërkombëtare të përmendura më sipër po rendisim dhe një sërë aktesh të tjera si:

- Deklarata e Parimeve Bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Abuzimit të Pushtetit, miratuar nga Rezoluta 40/34 e nëntorit 1985 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara. Përkrah përcaktimit të termit “viktimë”<sup>25</sup> ky dokument promovon edhe disa të drejta të tyre si veprimi i organet e drejtësisë dhe trajtim të drejtë ndaj tyre (që mes tjetërash nënkupton ndihmën juridike dhe njoftimin në kohë për të gjitha aspektet procedurale), restituim (rikthimi i pronës, kompensimi i dëmit, restaurimi i të drejtave, etj.), kompensim (i siguar nga shteti kur mjetet financiare të autorit të veprës penale janë të pamjaftueshme) etj.
- Konventa e Këshillit të Europës “Për kompensimin e viktimave të krimeve të dhunshme”<sup>26</sup> nuk rezultoi një normë ndërkombëtare efektive për shkak se ratifikimi i saj nga vendet anëtare të Këshillit të Europës zgjati shumë.
- Privatësia dhe identiteti i personave të trafikuar janë të mbrojtura (Neni 6 (1) Prot. i OKB-së për Trafikimin: Neni 11 i Konventës së KE për trafikimin, Neni 17 ICCPR: parimet e Rekomanduara të OHCHR, Udhëzimi 6 dhe 5(8). Kjo përfshin vendosjen e standardeve për ruajtjen e të dhënave personale dhe inkurajimin e mediave për të mbrojtur jetën private dhe identitetin e viktimave (Neni 11 i Konventës së KE për Trafikimin.)
- Identiteti i viktimave të trafikimit nuk është i shpallur publikisht dhe privatësia e tyre respektohet dhe mbrohet me të gjitha mjetet e mundshme, duke marrë në konsideratë të drejtën e të akuzuarit për një gjykim të drejtë. Personave të trafikuar ju jepet një paralajmërim paraprak për vështirësitë që hasen për mbrojtjen e identitetit dhe nuk u

---

<sup>25</sup> Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit adaptuar në Asamblesë të Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1985.

<sup>26</sup> E hartuar në Strasburg më 24.11.1983 dhe e ratifikuar nga shteti ynë më ligjin nr. 9265 datë 29.07.2004

jepen pritshmëri false dhe joreale në lidhje me mundësitë e autoriteteve për këtë çështje. (Parimet e Rekomanduara të OHCHR, Udhëzimi 6.6).

- Personave të trafikuar iu ofrohet këshillim dhe informacion mbi të drejtat e tyre ligjore, mbi procedimet gjyqësore dhe administrative në lidhje me to, në një gjuhë që e kuptojnë si edhe mbi shqetësimet që do të prezantohen dhe konsiderohen gjatë procesit penal (Neni 6(2) Prot. i OKB për Trafikimin : Neni 12 i Konventës së KE për Trafikimin : Parimet e Rekomanduara të OHCHR Udhëzimi 6 (5): *Deklarata e parimeve bazë të Drejtësisë për Viktimat e Krimin dhe Abuzimit me Pushtetin , paragrafi 8*).
- Personave të trafikuar iu jepet asistencë ligjore dhe lloje të tjera të ndihmës në lidhje me çdo padi penale apo civile kundrejt trafikuesve (Parimet e Rekomanduara të OHCHR, Udhëzimi 6(5)).
- Personave të trafikuar, të cilët merren si dëshmitarë (dhe kur është e nevojshme edhe familjarët), iu ofrohet mbrojtje efektive nga dëmtimi, kërcënimet, frikësimet apo hakmarrja e trafikantëve ose e personave të lidhur me ta, gjatë procesit të hetimit dhe të gjyqimit apo në çdo kohë që është e nevojshme për sigurinë e personit. Kjo mund të përfshijë dhënien e dëshmisë në mënyrë që të mbrojë sigurinë e tyre (p.sh nëpërmjet komunikimit video) identifikimin e një vendi të sigurt në shtetin e destinacionit: mbrojtjen e identitetit gjatë proceseve ligjore dhe identifikimin e mundësive për qëndrim të vazhdueshëm, risistemimin ose riatdhetësimin (Neni 25 i Prot. të OKB për Trafikimin , neni 28 i Konventës së KE për Trafikimin; Parimet e Rekomanduara të OHCHR, Udhëzimi 6,4.10 & 5.8).
- Statusi i çdo procedure ligjore të lidhur me viktimën e trafikimit merret në konsideratë në çdo vendim mbi riatdhetësimin (Neni 8(2) i Prot. të OKB për Trafikimin, Neni 16 i Konventës së KE për Trafikimin).
- Procedurat ligjore në të cilat personat e trafikuar janë të përfshirë, nuk influencojnë të drejtat, dinjitetin apo mirëqënien e tyre fizike dhe psikologjike (parimet e Rekomanduara të OHCHR, Udhëzimi 6.4).
- Masat marrin në konsideratë moshën, gjininë, dhe nevojat e veçanta të viktimës së trafikimit (Neni 6(4) i Prot. të OKB për Trafikimin). Viktimave të miturajepet mbrojtje e veçantë , duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës (Neni 28 i Konventës së KE për Trafikimin).
- Si akte Rekomanduese duhet të mbahet parasysh “Korniza e vendimit të dt.15.03.2001 të Këshillit të BE për pozitën e viktimave në procedimet penale, në të cilinparashikohet

se – “Shtetet duhet të shqyrtojnë në rast se ligjet dhe procedurat vendase janë të përshtatshme dhe përgjegjëse për viktimat e trafikimit, e të inkurajojnë kompensimin e tyre”. Rekomandimi nr.8511 i Komitetit të Ministrave të KE-së “Për pozicionin e të dëmtuarit në kuadrin e procedurës penale” parashikon se “një gjykatë penale duhet të urdhërojë kompensimin e të dëmtuarit nga vepra penale. Duhet të hiqen kufizimet ekzistuese dhe pengesat teknike që çojnë në mosrealizimin e një të drejte të tillë. Kompensimi duhet të jetë përparësi në rastin e një dënimi alternativ dhe gjykata duhet t’i kushtojë vëmendje nevojës për kompensim të dëmit.

- “Rekomandimi nr.8721 i Komitetit të Ministrave të KE-së ‘Mbi ndihmën e viktimave dhe parandalimin e diskriminimit’” shton se “Shtetet duhet të vlerësojnë masën e mbulimit të siguracioneve nga skemat private ose publike të sigurimit për sigurimin efikas të viktimave sipas nevojave të tyre”.
- “Rekomandimi nr.9713 i KE-së”Në lidhje me kërcënimin e dëshmitarëve dhe të drejtat e mbrojtjes” parashikon gjithashtu se “...masat që duhet të merren për trajtimin e dëshmitarëve veçanërisht në rastet e krimit në familje”’.
- Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e dt. 5 prill 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.
- Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të datës 25 tetor 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA”

#### Rastet kundër Qipros dhe Ruisë (7 Janar 2010)

*Paditësi ishte babai i një vajze të re, e cila vdiq në Qipro ku ajo kishte shkuar për të punuar në Mars të vitit 2001. Ai u ankua se policia qipriote nuk bëri gjithçka që duhej për të mbrojtur vajzën e tij nga trafikimi, kur ajo ende ishte gjallë dhe për të ndëshkuar ata që ishin përgjegjës për vdekjen e saj. Gjithashtu, u ankua për dështimin e autoriteteve ruse për të hetuar trafikimin e vajzës së tij dhe vdekjen pasuese si dhe për të marrë hapa për ta mbrojtur nga rreziku i trafikimit.*

*Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vuri në dukje se, si skllavëria, trafikimi i qenieve njerëzore, sipas natyrës dhe qëllimit të shfrytëzimit, u bazua në ushtrimin e kompetencave*

*bashkëlidhur të drejtës së pronësisë; trajtoi qeniet njerëzore si mallra që blihen dhe shiten dhe i jepte punë të detyruar; kjo nënkuptonte vëzhgim të afërt të aktiviteteve të viktimave, lëvizjet e të cilëve shpesh ishin të kufizuara; dhe përfshiu përdorimin e dhunës dhe kërcënimet kundër viktimave. Prandaj, Gjykata u shpreh se Neni 4 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut (ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar) nuk e lejon trafikimin, ajo arriti në përfundimin se pati shkelje nga Qiproja të detyrimeve të saj pozitive që lindin nga neni 4 i Konventës në dy pika:*

- Së pari, dështimin e saj për të krijuar një kuadër të përshtatshëm ligjor dhe administrativ për të luftuar trafikimin si rezultat i regjimit ekzistues të vizave për të punuar në rrugë.*
- Së dyti, dështimi i policisë për të marrë masa vepruese për të mbrojtur vajzën e paditësit nga trafikimi, pavarësisht nga rrethanat që shkaktuan dyshim të besueshëm se ajo mund të ketë qenë viktimë e trafikimit. Gjykata u shpreh se kishte edhe shkelje të nenit 4 të Konventës nga Rusia për shkak të dështimit për të hetuar se si dhe ku vajza e paditësit ishte rekrutuar dhe veçanërisht, të ndërmerreshin hapa për të identifikuar ata që u përfshinë në rekrutimin e saj ose metodat e rekrutimit që u përdorën. Më tej Gjykata tha se kishte pasur shkelje të Nenit 2 (e drejta për jetën) e Konventës nga Qiproja e si rezultat i dështimit të autoriteteve qipriote për të hetuar në mënyrë efektive vdekjen e vajzës së paditësit.*

*FA kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 20658 / 11)*

*10 shtator 2013 (vendimi mbi pranueshmërinë)*

*Paditësi, shtetase ganeze, pretendoi se ajo u trafikua në Mbretërinë e Bashkuar dhe u detyrua të shkojë për prostitucion. Ajo u ankua në veçanti se largimi i saj në Gana do ta rrezikonte atë të binte në duart e trafikantëve të saj të mëparshëm, ose në duart e trafikantëve të rinj. Ajo më tej pretendoi se, pasi kishte marrë HIV në Mbretërinë e Bashkuar si rezultat i drejtpërdrejtë i trafikimit dhe shfrytëzimit seksual, shteti kishte detyrimin ta lejonte të qëndrojë në Mbretërinë e Bashkuar për të hyrë në trajtim mjekësor të nevojshëm.*

*Gjykata i deklaroi ankimet e ankuesit sipas nenit 3 (ndalimi çnjerëzor ose degradues) dhe neni 4 (ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar) si të papranueshme.*

*Gjykata vuri në dukje në veçanti se paditësi mund të kishte ngritur të gjithë ankimimet e saja të Konventës në Gjykatën e Lartë. Mos aplikimi për leje për të apeluar në Gjykatën e Lartë, nuk kishte përmbushur kërkesat e nenit 35/1(kriteret e pranueshmërisë) të Konventës.*

J. dhe të tjerët kundër Austrisë (nr. 58216/12)17 janar 2017

*Ky rast lidhet me hetimin e autoriteteve austriake për një pretendim për trafikim personash. Paditësit, dy shtetas filipinas, të cilët kishin shkuar për të punuar si çift ne Emiratet e Bashkuara Arabe pretenduan se punëdhënësit e tyre i kishin marrë pasaportat dhe i shfrytëzonin ato. Ata thanë se ky trajtim kishte vazhduar gjatë një qëndrimi të shkurtër në Vjenë, ku punëdhënësit e tyre i kishin marrë dhe ku përfundimisht arritën të iknin. Pas një ankese penale të paraqitur nga paditësit kundër punëdhënësve të tyre në Austri, autoritetet zbuluan se nuk kishin juridiksionin mbi veprat e pretenduara të kryera jashtë vendit dhe vendosi të ndërpresë hetimin në rastin e paditësve lidhur me ngjarjet në Austri. Paditësit pohuan se i ishin nënshtruar punës së detyruar dhe trafikimit të qenieve njerëzore, dhe se autoritetet austriake kishin dështuar për të kryer hetimin e pretendimeve të tyre efektiv dhe shterues. Ata argumentuan në veçanti se çfarë kishte ndodhur në Austri nuk mund të shiheshin në izolim dhe se autoritetet austriake sipas ligjit ndërkombëtar hetonin ngjarjet që kishin ndodhur jashtë vendit.*

*Gjykata, duke gjetur se autoritetet austriake kishin respektuar detyrën e tyre për të mbrojtur paditësit si viktime (potenciale) të trafikimit të qenieve njerëzore, pohuan se nuk ka shkelje të nenit 4 të Konventës (ndalimi i punës së detyruar) dhe as të Nenit 3 (ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues). Veçanërisht vuri në dukje se nuk kishte asnjë detyrim sipas Konventës për të hetuar rekrutimin e paditësve në Filipine ose shfrytëzimin e supozuar të tyre në Emiratet Arabe, si shtete nuk kërkohen sipas nenit 4 të Konventës për tu siguruar nga Juridiksioni universal mbi veprat penale të trafikimit të kryera jashtë vendit.*

*Ky vendim do të bëhet i formës së prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44/2 (vendimet përfundimtare) të Konventes Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*

*Duke u kthyer tek ngjarjet në Austri, Gjykata arriti në përfundimin se autoritetet kishin ndërmarrë të gjitha hapat që duheshin në mënyrë të arsyeshme për situatën. Paditësit, të mbështetur nga OJF të financuar nga qeveria, intervistuar nga oficerë të trajnuar të policisë iu dha leja e qëndrimit dhe punës për të rregulluar qëndrimin e tyre në Austri, dhe u vendos*

*ndalimi i zbulimit të të dhënave personale për mbrojtjen e tyre. Për më tepër, hetimi i pretendimeve të paditësve për qëndrimin e tyre në Vjenë ishte i mjaftueshem për vlerësimin rezultativ të autoriteteve, duke pasur parasysh faktet e rastit dhe dëshmitë në dispozicion, ishin të arsyeshme. Çdo hap tjetër në këtë rast - siç është përballur me punëdhënësit e paditësve - nuk ka asnjë shans të arsyeshëm suksesi, pasi nuk ekzistonte marrëveshje e ndihmës së ndërsjelltë juridike midis Austrisë dhe Shqipërisë dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, dhe si paditësit ishin kthyer vetëm në polici për afërsisht një vit pas ngjarjeve në fjalë, kur punëdhënësit e tyre kishin kohë që kishin dalë jashtë vendit.*

LR kundër Mbretërisë së Bashkuar (nr. 49113/09)

*14 qershor 2011 (vendimi për grevë)*

*Paditësi pretendonte se ishte trafikuar në Mbretërinë e Bashkuar nga Italia nga një shqiptar që e detyroi atë të prostituonte në një klub nate, duke ja marrë të gjitha paratë që ajo kishte grumbulluar. Ajo u arratis dhe filloi të jetonte në një strehë të pazbuluar. Ajo pretendoi se largimi i saj nga Mbretëria e Bashkuar në Shqipëri do ta ekspozonte atë në një rrezik të trajtimit në kundërshtim me nenet 2 (e drejta për jetë), 3 (ndalimi i humanizimit ose i dënimit)*

*Ky aktgjykim do të bëhet i formës së prerë në rrethanat e përcaktuara në nenin 44/2 të Konventës.*

Duke u ndalur në mënyrë të veçantë tek dy aktet e fundit, jo çdo aspekt i tyre gjen referim në legjislacionin tonë procedural , atë material apo atë të veçantë.

Kështu, Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe mbrotjen e viktimave të trafikimit, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA jep përkufizime përshkruese të qarta në lidhje me trafikimin, viktimat e tij, mbëritjen e tyre, atë të veçantë të fëmijëve, mbi punën e detyruar si formë skllavërie, për lejet e qëndrimit të viktimave të trafikimit nga vendet e treta e se kush janë strukturat minimum me detyra të përcaktuara në mekanizmat antitrafikim.

Në një parashikim të veçantë kjo direktivë në nenin 12 kërkon:

1. të mos ketë përsëritje të panevojshme të seancave intervistuese e gjyqësore;
2. të mos ketë kontakte vizuale në mes të viktimës dhe të akuzuarit;
3. të evitohet dhënia e dëshmisë në seancë të hapur;
4. të evitohet pyetja e panevojshme në lidhje me jetën private.

Në mënyrë të veçantë direktika parashikon skemën e mbrotjes, asistencës, parandalimit e në mënyrë të veçantë për viktimat fëmijë të pashoqëruar, etj.

LE kundër Greqisë (nr.71545/12) 21 janar 2016

*Ky rast lidhet me ankimin e një shtetase nigeriane e cila u detyrua të prostituonte në Greqi. Zyrtarisht njohur si viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore me qëllim shfrytëzimin seksual, kërkuesit megjithatë u detyruan të prisnin më shumë se nëntë muaj pasi informoi autoritetet mbi situatën para se sistemi i drejtësisë t'i jepte atë status. Ajo paraqiti në mënyrë të veçantë se dështimet e Shtetit Grek për t'iu përmbajtur detyrimeve sipas nenit 4 të Konventës (ndalimi i skllavërisë dhe i punës së detyruar) shkaktoi shkelje të kësaj dispozite.*

*Gjykata u shpreh se pati shkelje të nenit 4 të Konventës (ndalimi i skllavërisë dhe i burgosjes, punë të detyruar). Ajo gjeti në veçanti që efektiviteti i hetimit paraprak dhe hetimet pasuese të rastit ishin komprometuar nga një sërë mangësish. Sa i përket procedurave administrative dhe gjyqësore, Gjykata gjithashtu vuri në dukje vonesa dhe dështime të shumta në lidhje me detyrimet procedurale të Shtetit Grek.*

*Në këtë rast Gjykata gjithashtu vlerësoi se pati shkelje të Nenit 6/1 të Konventës (e drejta për gjykim të drejtë brenda një kohe të arsyeshme), duke gjetur se kohëzgjatja e procedurës në fjalë ishte e tepruar për një nivel të juridiksionit dhe nuk plotësonte kërkesat e "kohës së arsyeshme". Së fundi, Gjykata vendosi se pati shkelje të nenit 13 të Konventës (e drejta për zgjidhje efektive) për shkak të mungesës mbi të drejtën e brendshme të mjetit juridik, me të cilin paditësi mund të kishte zbatuar të drejtën e saj për një seancë brenda një kohe të arsyeshme.*

**Koncepti i trafikimit në legjislacionin penal shqiptar.**

Legjislacioni ynë penal ka reflektuar frymën e normave ndërkombëtae të cituara më sipër duke përbushur detyrimin e tyre për cilësimin si vepër penale trafikimin e qënieve njerëzore.<sup>27</sup> Edhe këtu është e rëndësishme të kujtohet se detyrimi në Protokollin për Trafikimin për ta cilësuar si vepër penale trafikimin e qënieve njerëzore nuk kërkon që legjislacioni vendas të përdorë të njëjtën mënyrë shprehjeje me përkufizimin e trafikimit të qënieve njerëzore. Në vend të kësaj, është e mira që legjislacioni vendas të përpilohet në një mënyrë që të përputhet me kuadrin ligjor të brendshëm të vendit tuaj, me kusht që të përmbajë një ndërthurje të elementeve përbërës qëmban përkufizimi.

Kodi Penal i yni ka pësuar disa ndryshime në veprat penale të trafikimit të qënieve njerëzore<sup>28</sup> por në thelb ai përmban pothuajse *mot a mot* përfufizimin e dhënë nga Protokollin i Palermos dhe Konventa e Varshavës. Kodi ynë penal parashikon si forma të trafikimit të qënive e njerëzore atë të emigrantëve, femrave për prostitucion dhe si formë më vete atë të trafikimit të të miturve. “*Trafikimit të personave të rritur*“, neni 110/a i KP<sup>29</sup> dhe “*Trafikimi i të miturve*”, neni 128 i KP

Kështu **neni 110/a i KP “Trafikimi i personave të rritur”** parashikon;

*Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*

---

<sup>27</sup>Detyrim që rrjedh nga neni 5 i Protokollit shtesë mbi Trafikimin, pjesë e Konventës së OKB.

<sup>28</sup><sup>28</sup> Neni 110/a, Trafikimi i personave të rritur ( *Shtuar me ligjin 8733, datë 24.1.2001; ndryshuar me ligjin nr. 9188, datë 12.2.2004; ndryshuar titulli, fjalët në paragrafin e parë dhe paragrafi i tretë dhe shtuar paragrafi i dytë me ligjin nr. 144, datë 2.5.2013; shfuqizuar pjesa që parashikon edhe dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim, me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013* )

<sup>29</sup> Me ligjin nr. 144/2013 vepra penale e “Trafikimit të femrave”, neni 114/b u shfuqizua duke përfshirë trafikimin e femrave tek neni 110/a i KP.



*Kur kjo vepër kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*

*Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*

*Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.*

*Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.*

*Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me 1/4 e dënimit të dhënë. Nenet vijuese 110/b dhe 110/c<sup>30</sup> kanë penalizuar përfitimin e shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar si dhe veprimet që lehtësojnë trafikimin.*

Po ti referohemi ndryshimeve të bërë Kodin Penal<sup>31</sup> në 2013, në dispozitat e trafikimit, sin në nenin 110/a dhe 128/b nuk është aplikuar rritja e dënimit për rrethanat rëndëuese. Duket që është më tepër një lapsur në momentin e shkrimit të neneve por që në fakt prodhon efekte të rënda në aplikimin e tij. Dhe për më tepër në paragrafin e tretë të nenit 110/a<sup>32</sup> aplikohet një dënim më i butë edhe pse jemi në rrethana rëndëuese. Prë rrjedhojë duhen rishikuar të dyja

---

<sup>30</sup>Shtuar me ligjin nr. 144/2013, datë 2.5.2013. Përfitimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruar nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj një fëmije dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.

“Falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave të rritur, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, apo është kryer nga personi që ka për detyrë të lëshojë letërnjoftimin, pasaportën, vizën apo dokumentin e udhëtimit, ose ka mundësuar trafikimin e fëmijëve, dënohet me burgim nga katër deri në tetë vjet.

<sup>31</sup>Me ligjin nr. 144/2013

<sup>32</sup>Neni 110/a I KP paragrafi I tretë: - “Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet”

dispozitat për të bërë ndryshimet e duhura. **Neni 128/b “Trafikimi i të miturve”** parashikon se:

*Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.*

*Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.*

*Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasojë të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.*

*Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.*

*Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me 1/4 e dënimit.*

Vepra penale e trafikimit të qënieve njerëzore ishte në kompetencën e hetimit e gjykimit të institucioneve të veçanta të ngritura në vitin 2004<sup>33</sup>, Prokurorisë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Krimeve të Rënda, pasi trajtoheshin në mënyrë të veçantë si krime të rënda e në të njëjtin nivel me ato të krimit të organizuar.

Neni 75/a i KPrP parashikonte që veprat penale “*Trafikimit personave të rritur*”<sup>34</sup>, neni 110/a i KP<sup>34</sup> dhe “*Trafikimi i të miturve*”, neni 128 i KP ishin në kompetencën lëndore të Gjykatës së Krimeve të Rënda. Kjo përkonte mestrategjine në nivel shtetëror dhe kombëtar në luftën kundër

<sup>33</sup> Ligji nr. 9110 datë 24.07.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave për krime të rënda”

<sup>34</sup> Me ligjin nr. 144/2013 vepra penale e “Trafikimit të femrave”, neni 114/b u shfuqizua duke përfshirë trafikimin e femrave tek neni 110/a i KP.

trafikimit<sup>35</sup>dhe një praktikë të konsoliduar hetimore dhe gjyqësore në trajtimin e këtyre veprave penale, e në mënyrë të veçantë në trajtimin e viktimave.

Me ndryshimet e fundit në Kodin e Procedurës Penale<sup>36</sup>*vepra penale e trafikimit të qenieve njerëzore*ku përfshihet dhe *trafikimi i personave të rritursi* dhe *ajo e trafikimit të të miturve* do të gjykohen nga gjykatat e juridiksionit të përgjithshëm.<sup>37</sup>Mendimi yne dhe disa ekspertëve të fushës, si dhe Koalicionit të Strehëzave Antitrafik ka qenë që Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar duhet të ketë të njëjtën kompetencë lëndore si Gjykata e Krimeve të Rënda përsa i përket veprave penale të trafikimit të qenieve njerëzore, armëve, narkotike si dhe akteve terroriste. Kjo pasi kjo natyrë kriminaliteti në aktet ndërkombëtare në nivelin e OKB e atyre të Këshillit të Europës konsiderohen forma të krimit të organizuar. Konventa e OKB “Për luftën kundër krimit të Organizuar Ndërkombëtar”, jep konceptin i *krimit të rëndë (serious crimes* – në referim të nenit 2 shkronja b) të Protokollit të Palermos në Shqipëri, dhe cilëson si formë të krimit të organizuar trafikimin e qenieve njerëzore, të emigrantëve, femrave për prostitucion dhe fëmijëve<sup>38</sup>. Gjykimi i deritanishëm i këtyre çështjeve nga Gjykata për Krime të Rënda ka bërë të mundur zbatimin e një standardi uniform mbi trajtimin e viktimave, aplikimin e bashkëpunëtorëve të drejtësisë, dëshmitarëve të mbrojtur, pyetjen në distancë dhe zbatimin e një politikë penale adekuate ndaj autorëve të këtyre veprave penale.

Si për gjyqtarin e hetimeve paraprake, ashtu dhe atë të seancës paraprake, në rastet kur kanë një kërkesë për sigurimin e provës, të thënieve të një viktime trafikimi,duhet të bëjnë kujdes në vlerësimin e kriterëve mbi të cilat është bazuar kërkesa, pasi kjo kategori dëshmitarësh janë kategoria me e dobët e personave ndaj të cilëve qoftë presioni, dhuna psikologjike, por dhe vetë ambienti apo fakti që janë të përfshirë në një procedim si persona që kanë dhënë deklaratime ndikon.

Në mënyrë eksplicite nga KPrP parashikohet qëviktima të ketë këto të drejta si më poshtë vijon:

---

<sup>35</sup>Strategjia e luftës kundër trafikimit të personave dhe plani i veprimit 2014 – 2017, VKM nr. 663 datë 17.07.2013 dhe VKM nr. 814 datë 26.11.2014.

<sup>36</sup>Ligji nr.35/2017 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7905 datë 21.03.1995 “Kodi i Procedurës Penale në RSH””

<sup>37</sup>Sipas dispozitave kalimtare të ligjit nr. 35/2017, nenet që rregullojnë kompetencën bëhen të zbatueshme me krijimin e Gjykatës së Posaçme Antikorrupsion dhe Krimit të Organizuar,prandaj deri atëherëçështjet e trafikimit të qenieve njerëzore e të miturve do të gjykohen nga Gjykata për Krime të Rënda.

<sup>38</sup>Protokollit 1 dhe 2 shtese i Konventës së OKB për luftën kundër krimit të organizuar “.

- të ketë ndihmë mjekësore, ndihmë psikologjike, këshillim dhe shërbime të tjera të ofruara nga autoritetet, organizatat;<sup>39</sup>
- të ketë në dispozicion një avokat mbrojtës, duke u përjashtuar në të njëjtën kohë nga pagimi i çdo shpenzimi për marrjen e akteve dhe tarifave gjyqësore për paraqitjen e kërkesë-padisë që lidhen me statusin e viktimës së veprës penale;
- të bëjë ankim në gjykatë kundër vendimit të prokurorit për të mos filluar procedimin dhe vendimit të prokurorit ose gjyqtarit të seancës paraprake për të pushuar akuzën ose çështjen;
- të kërkojë shpërblimin e dëmit dhe të pranohet si paditës civil në procesin penal;
- të thirret në seancën paraprake dhe në seancën e parë gjyqësore;
- të dëgjohet nga gjykata, edhe kur asnjëra nga palët nuk ka kërkuar thirrjen e saj si dëshmitar.

Viktima që nuk ka zotësi për të vepruar i ushtron të drejtat e saj nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit të tij, përveçse kur kjo nuk është në interesin e viktimës. Kur vëren papajtueshmëri mes interesave të viktimës dhe atyre të përfaqësuesit ligjor ose kujdestarit, gjykata cakton një kujdestar të posaçëm, në përputhje me dispozitat e Kodit të Familjes. Trashëgimtarët e viktimës kanë të drejtat e parashikuara<sup>40</sup>. Nëse trashëgimtari i viktimës është i mitur, ai përfaqësohet nga kujdestari ligjor.

Në zbatim të këtyre dispozitave do të lindë diskutimi se cili do të jetë trashëgimtari ligjor dhe nëse referenca duhet të bëhet në dispozitat e Kodit Civil bazuar në rradhën e preferimit. Gjithashtu, mund të lindë diskutimi nëse viktima duhet të varet në çdo rast nga trashëgimia. Kjo pasi mund të ketë persona në një lidhje shumë të afërt me viktimën si dhe trashëgimtarë ligjorë në rradhë preferimi të lartë, të cilët mund të kenë shkëputur lidhjet me viktimën. Termi “trashëgimtarë” lehtëson proceduralisht fazën e hetimit e gjykimit, por në fakt si i tillë mund të jetë çdo anëtar i familjes.

Në mënyrë të veçantë KPrP ka shprehur e përcaktuar të drejtat e viktimës së abuzuar seksualisht dhe viktimës së trafikimit të qenieve njerëzore,<sup>41</sup> që veç të drejtave të parashikuara në nenet

<sup>39</sup>Neni 58 i KPrP “Të drejtat e viktimës së veprës penale”

<sup>40</sup> Të drejtata e parashikuara në shkronjat “a”, “e”, “ë”, “f”, “g” dhe “j”, të paragrafit 1, të nenit 58 të KPrP

<sup>41</sup> Neni 58/b i Kodit i shtuar me ligjin nr. 35/2017.

58 dhe 58/a, të këtij Kodi, viktimat e abuzuar seksualisht dhe viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore kanë gjithashtu të drejtë:

- të refuzojnë t'u përgjigjen pyetjeve në lidhje me jetën private, e cila qartësisht nuk ka lidhje me veprën penale;
- të kërkojnë të dëgjohen nëpërmjet mjeteve audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi.<sup>42</sup>

Për të miturin viktimat të veprës penale të trafikimit apo shfrytëzimit seksual, Kodi ka parashikuar në mënyrë të veçantë të drejtat dhe garancitë që njohu Konventa e Lanzarote<sup>43</sup>, sipas së cilave fëmija viktimë e trafikimit ka të drejtë:

- të shoqërohet nga një person i besuar prej tij;
- të ruajtjes së konfidencialitetit të të dhënave personale;
- të kërkojë, nëpërmjet përfaqësuesit, që gjykimi të zhvillohet pa praninë e publikut.<sup>44</sup>

Gjykata duhet ta trajtojë **viktimën e mitur** të veprës penale duke mbajtur parasysh moshën, personalitetin dhe rrethanat të tjera, me qëllim shmangien e pasojave të dëmshme për zhvillimin dhe edukimin e saj të ardhshëm. Nëse ekziston mundësia që viktimat të jetë e mitur dhe moshën e viktimës nuk dihet, prezumohet se ajo është e mitur.

Më tej Kodi ka parashikuar dhe mundësinë e përdorimit si provë të pyetjes së të miturit gjatë fazës së hetimeve. Viktimat e mitur pyetet pa vonesë nga persona të specializuar për këtë qëllim. Kur është e mundur dhe e përshtatshme, biseda regjistrohet me mjete audiovizive, sipas parashikimeve të këtij Kodi. Ky regjistrim mund të përdoret si provë në procedimin penal dhe vlerësohet së bashku me provat e tjera, sipas kriterëve që parashikohen nga paragrafi 4, i nenit 361/a, të këtij Kodi. Kur viktimat e mitur është nën 14 vjeç, biseda zhvillohet në mjedis të

---

<sup>42</sup> Këto të drejta janë reflektim i të drejtave të garantuara për viktimat nga Konventa e Palermos, ajo e Varshavës e Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”, e ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006, në mënyrë të veçantë nga Rekomandimi nr. (85) 11-Këshilli i Europës, Vendimi Kuadër i BE mbi Statusin e Viktimave në Gjykimin Penal e datës 15.03.2001, Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrotjen e viktimave të trafikimit, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA, Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA”.

<sup>43</sup> Konventa e Këshillit të Europës për mbrotjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual, e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 10 071 datë 9.2.2009.

<sup>44</sup> Shkonjat a, b, c të paragrafit të parë të nenit 58/a të KP.

përshatura për të. Një gjë të tillë e parashikon dhe Kodi i Drejtësisë për të Miturit<sup>45</sup>, i cili në nenin 39, 41 të tij ka parashikuar rregulla të veçanta për pyetjen e të miturit viktimë ose dëshmitar, dhe të miturin viktimë e shfrytëzimit seksual dhe dhunës seksuale.

Në lidhje me **njoftimin e viktimës** për seancën gjyqësore ashtu sikurse dhe për njoftimin e të pandehurit, tashmë Kodi ka parashikuar mënyra alternative të njoftimit të saj. Sipas ndryshimeve të fundit<sup>46</sup>, njoftimi i viktimës bëhet njëloj sikurse dhe njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë, referim ky në kryerjen e njoftimit sipas nenit 140 të KPrP<sup>47</sup> dhe kur kjo nuk është e mundur pasi nuk dihen vendet ku ndodhet viktima, njoftimi do të bëhet nëpërmjet depozitimit të aktit në kryesekretari. Kjo është e kuptueshme pasi në rastet e viktimave të trafikimit nuk mund të bëhet njoftimi publik nëpërmjet shpalljes siç bëhet për të pandehurin në gjendje të lirë sipas paragrafit 5 të nenit 140 të KPrP, sepse një mënyrë e tillë njoftimi e ekspozon atë në publik. Gjithashtu, në rastin e viktimave të trafikimit, për të njëjtën arsye nuk mund të zbatohet neni 138 i KPrP, i cili parashikon njoftimin e viktimave nëpërmjet shpalljes publike, pasi kjo mënyrë njoftimi i referohet rastit kur kemi viktima me një numër të madh personash nga një dëm në shëndet apo material e jo rasti i viktimave të trafikimit.

**Procedra e gjykimit të veprave penale të trafikimit** duhet të mbrojë viktimën e në veçanti viktimën e mitur nga riviktimizimi dhe ekspozimi i jetës private apo detajeve që çenojnë personalitetin e integritetin e saj/ tij.<sup>48</sup> Gjykata mund të vendosë që gjykimi të bëhet me dyer të mbyllura kur publiciteti dëmton moralin shoqëror, kur gjykohet e nevojshme për pyetjen e të miturit, ose viktima vetë kërkon të zhvillohet gjykimi me dyer të mbyllura.<sup>49</sup> Ndërsa shqyrtimi gjyqësor zhvillohet gjithmonë me dyer të mbyllura kur të miturit janë autorë të një vepre të tillë, ose kur gjykohen të pandehur të rritur, të cilët akuzohen për kryerjen e veprave penale ndaj të miturve si viktimë, pavarësisht moshës së viktimës gjatë gjykimit.<sup>50</sup>

---

<sup>45</sup>Ligji nr. 37/2017 datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë për të Miturit“, i cili ka hyrë në fuqi me datën 1 janar 2018

<sup>46</sup>Neni 137 i KPrP i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017.

<sup>47</sup>Njoftimi për herë të parë i të pandehurit në gjendje të lirë.

<sup>48</sup>Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore”, e ratifikuar me ligjin nr. 9642, datë 20.11.2006, Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA”.

<sup>49</sup>Neni 340 i KPrP, paragrafi 1 shkronjat a, c, d.

<sup>50</sup>Rregullat Minimale Standard të Kombeve të Bashkuara për Administrimin e Drejtësisë për të miturit (Rregullat e Pekinit 1985) Udhëzimet e Kombeve të Bashkuara për Parandalimin e Kriminalitetit të Rinjtë (Udhëzimet e Riadit)

Në lidhje me **zhvillimin e gjykimit me dyer të mbyllura**, viktima ose përfaqësuesi i të miturit viktimë mund të kërkojë që procesi të zhvillohet me dyer të mbyllura, qoftë edhe vetëm për një pjesë të procesit. Procedohet gjithmonë me dyer të mbyllura kur personi i dëmtuar është i mitur. Kjo dispozitë ka një rëndësi të madhe sistematike dhe praktike. Përpara së gjithash futja e normave të reja, që nuk kanë patjetër natyrë seksuale, pasi trafikimi mund të ketë si qëllim punën e detyrueshme ose servitutit shtëpiak, - nënkupton që *la ratio* e normës nuk është mbrojtja më e madhe e nevojshme e personit të dëmtuar, sepse seksualiteti i tij është implikuar në kryerjen e veprës. Në fakt *la ratio* është për të kërkuar mbrojtjen e nevojshme të jetës personale të viktimës, kur janë dëmtuar nga veprat të mirat personale, që përfshihen në një gamë më të gjerë, duke përfshirë lirinë personale, lirinë e vetëvendosjes si në sferën seksuale ashtu edhe më në përgjithësi, kur pra personi ka qenë objekt i një dëmtimi të tillë, sa e ka cënuar autostimën e tij dhe kuptimin e vetë vlerës së personit të tij. Në këtë situatë, publiciteti vetë mund të jetë një faktor rëndimi i pasojave të dhunimit.

Nga këndvështrimi praktik, personi i dëmtuar duhet të informohet gjithmonë në momentin e kontaktit me autoritetin gjyqësor, të së drejtës së tij për të kërkuar që debati ose një pjesë e tij- *tipikisht dëshmia e tij*- të zhvillohet me dyer të mbyllura. Gjyqtari ose kryetari duhet më pas të vlerësojnë në një mënyrë jo shumë shtrënguese ekzistencën e rrethanave për marrjen e një vendimi të tillë. Kjo sipas *Rekomandimit të Këshillit të Europës nr. 85 (2011)*<sup>51</sup>. Në çdo rast kjo e drejtë vihet në balancë me të drejtën e të akuzuarit për garantimin e barazisë së armëve gjatë procesit.

Kërkesat për zhvillimin me dyer të mbyllura në Gjykatën e Krimeve të Rënda gjithmonë kanë patur rezistencën e të pandehurve të akuzuar e mbrojtësve të tyre të cilët kërkonin ballafaqimin me viktima akuzuese në sallën e gjykimit. Në disa raste të pandehurit dhe mbrojtësit e tyre janë larguar nga salla e gjykimit në shenjë proteste të pranimit nga ana e gjykatës së kërkeses për zhvillimin e seancës me dyer të mbyllura.

Një disavantazh në gjykimin e çështjeve të trafikimit është mungesa e njohurive apo pranimit i standardeve ndërkombëtare të avokatëve mbrojtës përsa i përket trajtimit të viktimave të trafikimit të parashikuara nga normat ndërkombëtare të OKB e BE, e të cilat ishin pjesë

---

<sup>51</sup>Politikat e informimit dhe te marrredhenies me publikun ne kuadrin e instruksionit dhe te gjykimit te veprave penale duhet te kene parasysh nevojjen per te mbrojtur viktimen nga cdo publicitet qe mund te paragjykoje jeten e tij private ose dinjitetin e tij. Nese lloji i vepres penale, statusi i veçante, situata ose siguria personale e pales se demtuar kerkojne nje mbrojtje te veçante, procesi penal para vendimit duhet te zhvillohet me dyer te mbyllura dhe nese detyrueshme te dhenave personale te viktimes duhet te jete objekt i shtrëngimeve te pershtatshme”

legjislacionit tonë të brendshëm, por akoma nuk ishin reflektuar në legjislacionin procedural. Prandaj parashikimi tashmë i këtyre të drejtave, ndër të cilat dhe ajo për të kërkuar vetë viktimë apo përfaqësuesi i saj/tij/të miturit zhvillimin me dyer të mbyllura, apo përdorimin si provë të pyetjes audio vizive gjatë hetimeve, ndihmon gjyqtarët në praktikën e zbatimit të këtyre standardeve.

### **Prania e viktimës së trafikimit në seancë gjyqësore dhe pyetja e saj me cilësinë e dëshmitares në seancë gjyqësore**

Gjatë seancës gjyqësore të shqyrtimit të çështjes, viktimë e trafikimit mund të marrë pjesë në pozicionin e viktimës<sup>52</sup>, duke asistuar në proces gjyqësor ose në pozicionin e dëshmitares kur është e nevojshme pyetja e saj me këtë cilësi. Pyetja e viktimës së trafikimit si dëshmitare e sidomos rasti kur kjo/ky është i mitur është pjesa me delikate e procesit. Kur thëniet e dëshmitares/viktimë trafikimi janë siguruar gjatë hetimeve paraprake, apo seancës paraprake situata është më e thjeshtë pasi në seancë gjyqësore lexohet procesverbali i sigurimit të provës. Prania e viktimës së trafikimit si dëshmitar në seancë kërkon plotësimin e disa komponentëve që lidhen me sigurinë, shoqërimin, pozicionimin e saj në ambientet e gjykatës, apo sallën e gjykimit.

Pyetja e viktimës së trafikimit mund të bëhet nëpërmjet **mjeteve audio dhe audio vizive** sipas nenit 361 paragrafi 8 i KPrP.<sup>53</sup> Kjo realizohet nëpërmjet lidhjeve me vidiokonferencë ose duke e pyetur dëshmitaren, viktimën, nga një ambient i rezervuar, por të ngjitur me sallën e gjykimit, ambient në të cilin ajo nuk ka pamje të drejtpërdrejtë me të pandehurin, avokatin dhe publikun. Kjo mënyrë pyetje bëhet për të siguruar mbrojtjen e dëshmitarëve, viktimave të trafikimit nga kërcënimet serioze të të pandehurve dhe personave të tjerë, nëpërmjet të cilave krijoheshin vështirësi serioze për vërtetimin e fajësisë dhe dënimin e tyre. Sallat e gjykimit në Gjykatën e Krimeve të Rënda janë konceptuar për të realizuar një pyetje të tillë nëpërmjet vidiokonferencës, duke e vendosur dëshmitaren në një ambient në gjykatë, ose nga një ambient tjetër jashtë gjykatës, ose nëpërmjet lidhjes audio me ambientin e veçantë, por ngjitur me sallën e gjykimit. Kjo mënyrë pyetje nëpërmjet lidhjes audio apo audiovizive është praktikuar me

---

<sup>52</sup>Sipas nenit 58 paragrafi 1 shkronja h, viktimë ka të drejtë të thirret nga gjykata në seancën e parë gjyqësore.

<sup>53</sup> Viktimat e veprave penale seksuale, veprave të trafikimit ose veprave të kryera brenda familjes, kur e kërkojnë, mund të pyeten si dëshmitare nëpërmjet mjeteve audio dhe audiovizive.



sukses në proceset gjyqësore në gjykim në GjKR.<sup>54</sup> Në një rast të tillë kryesuesi i seancës bën verifikimin e prezencës së dëshmitares/viktimë dhe një sekretare mban paralelisht një procesverbal në ambientin ku ndodhet dëshmitari. Procesverbali i bashkangjitet proceverbali kryesor të seancës gjyqësore ose rregjistrimit audio.

Sipas pikës 7 të nenit 361 të KPrP, pyetja e dëshmitares/viktimë në distancë mund të bëhet brenda territorit të vendit tonë, ose jashtë vendit nëpërmjet vidiokonferencës. Ligji parashikon që gjatë kësaj pyetje në distancë duhet të respektohen rregullat e marrëveshjeve ndërkombëtare dhe dispozitat e Kodit tonë të Procedurës Penale. Dëshmitaria/viktimë trafikimi pyetet nëpërmjet lidhjes audio-vizive dhe personi i autorizuar nga Gjykata qëndron në vendin ku ndodhet ajo dhe bën identifikimin e tij/saj, si dhe kujdesit për zhvillimin e rregullt të marrjes në pyetje e për zbatimin e masave të mbrojtjes. Këto veprime ai i pasqyron në proces-verbal.

Në rastet kur viktima/e trafikuar **zgjedh të jetë prezent gjatë gjykimit** dhe të pyetet në prani të të pandehurit, gjykata duhet të bëjë kujdes që:

- Viktima e trafikimit/dëshmitaria, të shoqërohet nga punonjës policie dhe punonjës social ose psikologë mundësisht të së njëjtës gjini<sup>55</sup>. Në rastet kur viktima ndodhet e akomoduar në qendrat pritëse për viktimat e trafikimit edhe mundësia e shoqërimit të tyre në mënyrë të asistuar është më e lehtë, pasi gjykata urdhëron shoqërimin e saj nga punonjësit e qendrës pritëse.
- Ajo shoqërohet në ambientet e gjykatës nga një hyrje që nuk është e aksesueshme për publikun dhe shoqërohet në një ambient të përcaktuar në mënyrë të posaçme për dëshmitaret (*dhoma e dëshmitarëve*), ambient në të cilën është e shoqëruar nga punonjësja sociale ose psikologia<sup>56</sup>, ku dhe qëndron derisa nëpunësi gjyqësor e thërret për tu paraqitur për pyetje.
- Viktima/dëshmitare pozicionohet në një ambient në sallë që të ketë distancë të përshtatshme nga i akuzuari/i pandehuri në mënyrë që ajo të mos intimidohet e të ndjejë presion psikologjik nga ballafaqimi me tëpandehurin.<sup>57</sup>

---

<sup>54</sup> Shih vendimin nr. 77 datë 19.07.2017 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në ngarkim të pandehurit L.M i akuzuar për veprën penale të “*Trafikimit të të miturve*” neni 128/b/3 i KP ku përshkruhet mënyra e pyetjes me vidiokonferencë nga një ambient i brendshëm i Gjykatës i të miturës/ viktimë trafikimi A.F.

<sup>55</sup> Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA

<sup>56</sup> Shkronja b) e nenit 58 të KPrP.

<sup>57</sup> Sallat e gjykimit në Gjykatën e Krimeve të Rënda sigurojnë këtë komponent pasi kanë një largësi të mjaftueshme me vendin ku pozicionohet viktima.

- Gjykata bën kujdes që gjatë pyetjes nga palët, prokurori, avokatët apo i pandehuri të mos përdoren pyetje, gjeste, sjellje, intonacione që të shkaktojnë presion psikologjik, intimidim, ekspozim të intimitetit apo fyerje e denigrim të viktimës së trafikimit, e cila është paraqitur si dëshmitare.

Sipas nenit 361/b të KPrP,<sup>58</sup> kur viktima e trafikimit është dëshmitare e mbrojtur dhe ka përfituar nga programi i mbrojtjes së dëshmitarëve, ajo mund të pyetet sipas teknikave të veçanta të marrjes në pyetje, ndër të cilat përveçpyetjes në distancë është dhe ajo e fshehjes së identitetit. Në ligjin “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”<sup>59</sup>, janë të përcaktuara rastet kur merret statusi i dëshmitares së mbrojtur<sup>60</sup> dhe detyrimi i organeve të posaçme administrative për marrjen e masave të veçanta mbrojtëse, fizike dhe teknike, në vendin ku qëndron personi i mbrojtur, si dhe gjatë lëvizjes së tij, përfshirë edhe ato për përmbushjen e detyrimeve ndaj organeve të drejtësisë. Në lidhje me ndryshimin e identitetit të dëshmitarit të personit që do të pyetet nga gjykata sipas nenit 361/b të KPrP, gjykata urdhëron marrjen e masave të përshtatshme në rast se është e domosdoshme njohja e identitetit ose kqyrja e personit, gjykata urdhëron thirrjen ose shoqërimin e detyrueshëm të tij, me qëllim që të përmbushë këtë detyrim. Masat mbrojtëse që mund të urdhërojë gjykata janë ato që kanë të bëjnë me fshehjen e të gjithë shënimeve që do të zbulonin identitetin e palës së dëmtuar apo të dëshmitarit, masat për të fshehur tiparet apo përshkrimin fizik të dëshmitarit, seancat me dyer të mbyllura për publikun; aktivitete në këtë fushë.

Deri tani, në Gjykatën e Krimeve të Rënda nuk ka patur raste të dhënies së këtij statusi viktimave të trafikimit, por gjithsesi kur ato kanë qenë dëshmitarë, gjatë sigurimit të provës apo dëshmisë janë shoqëruar me punonjës policie për në Gjykatë të asistuar nga aktivistët shoqërisë civile apo të organizatave të ndryshme që ushtrojnë

### **Pyetja e të miturit viktimë e trafikimit**

<sup>58</sup> Teknikat e veçanta të marrjes në pyetje.

<sup>59</sup> Ligji nr.9205 dt.15.03.2004 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 10 173 datë 22.10.2009 dhe ligjin nr. 32/2017 datë 30.03.2017.

<sup>60</sup> ‘Dëshmitari i drejtësisë’ është personi, ndaj të cilit zbatohen masat e posaçme të mbrojtjes, i cili në cilësinë e dëshmitarit ose personit të dëmtuar, bën njoftime ose dëshmon për fakte dhe rrethana, që përbëjnë objekt prove në një procedim penal, për vepra penale të parashikuara në pikën 7 të këtij neni (përfshihen edhe veprat penale lidhur me trafikimin ). Viktimat e trafikimit mund të paraqiten shpesh në këtë pozitë procedurale.

Përveçrregullave të sipërcituara, pyetja e të miturit/es viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, legjislacioni procedural penal dhe ai i drejtësisë për të miturit kanë parashikuar tashmë rregulla të reja për të ofruar garancitë maksimale për sigurimin e efektivitetet të marrjes së dëshmisë, por ajo që është më kryesore, trajtimin e përshatshëm të të miturit. Kodi i Drejtësisë për të Miturit jep përkufimimin e “*të miturit*”, “*të miturit viktimë*”, “*riviktimizimit*” si dhe “*interesit më të lartë të të miturit*”<sup>61</sup>.

Tashmë neni 361 i KPrP parashikonn rregulla të veçanta për pyetjen e të miturit.<sup>62</sup> Kështu, pyetja e të miturit/viktimë trafikimi, nën 14 vjeç, bëhet pa praninë e gjyqtarit apo të palëve në ambientin ku ai ndodhet, dhe kryhet nëpërmjet lidhjeve audiovizive ose audio. Pyetja bëhet nëpërmjet psikologut, edukatorit etj.

Ndërsa pyetja e të miturit viktimë mbi 14 vjeçbëhet nga gjyqtari/kryesues i trupit gjykues që në rastin tonë të gjyqimit në shkallë të parë korrespondon me gjyqtarin e çështjes, duke bërë kujdes për të shmatur pasojat e dëmshme në shëndetin e tij, në mënyrë që të mos impresionohet apo tensionohet emocionalisht gjatë pyetjes.

Kur i mituri është dëgjuar gjatë hetimit dhe deklaratimet e tij janë rregjistruar sipas paragrafit 4 të nenit 58/a të KPrP, ato përdoren si provë në gjykim nëse i pandehuri dhe mbrojtësi japin pëlqimin. Një gjë të tillë e parashikon dhe Kodi i Drejtësisë për të Miturit<sup>63</sup>, i cili në nenin 39, 41 të tij ka parashikuar rregulla të veçanta për pyetjen e të miturit viktimë ose dëshmitar, dhe të miturin viktimë e shfrytëzimit seksual dhe dhunës seksuale.

---

<sup>61</sup>Neni 3 “Përkufizime”. Kodi i drejtësisë për të Miturit i miratuar me ligjin nr. 37/2017.

<sup>62</sup> Neni 361 i KPrP “Pyetja e të miturit 2, i ndryshuar me lgjin nr. 35/2017.

<sup>63</sup>Ligji nr. 37/2017 datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë për të Miturit”, i cili hyn në fuqi me datën 1 janar 2018

## PRAKTIKA NDËRKOMBËTARE NË HARTIMIN E LIGJEVE TË VEÇANTA

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Ligjet Federale Anti-Trafikim

Akti për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit i vitit 2000<sup>64</sup>, është ligji i parë federal që adreson trafikimin e personave me një fokus të veçantë në dimensionin ndërkombëtar të fenomenit. Ai ka si *“qëllim luftën kundër trafikimit të personave, si formë e skllavërisë moderne, viktimat e të cilit janë kryesisht gra dhe fëmijë, të sigurojë dënimin e drejtë dhe efektiv të trafikantëve, dhe të mbrojë viktimat”*<sup>65</sup>.

Ky ligj ka një qasje të bazuar në tre shtylla, që përfshijnë parandalimin nëpërmjet programeve ndërkombëtare dhe një programi shtetëror të monitorimit, mbrojtjen nëpërmjet vendosjes së vizave të tipit T dhe shërbimeve për viktimat e huaja, si dhe ndjekjen penale nëpërmjet krimeve të reja federale. Ky akt më tej ka pësuar disa ndryshime në vitet 2003, 2005, 2008, 2013 dhe 2015, që përfshinë më shumë mbrojtje për viktimat vendase, dhe fuqizuan rolin e Zyrës së Trafikimit të Personave në Departamentin e Shtetit.

Një seksion i veçantë i është kushtuar përkufizimit të formave të shfrytëzimit, mënyrës së rekrutimit, viktimës, standardeve të veprimeve që ndërmerren për luftën ndaj trafikimit, autoriteteve, task forcës ndërinstitucionale për monitorimin dhe luftën kundër trafikimit, si dhe asistencës ndaj viktimave të trafikimit.

### Parandalimi

- Krijon zyrën për Monitorimin dhe Luftën kundër trafikimit brenda Departamentit të Shtetit, të cilës i kërkohet të raportojë mbi renditjen e shteteve për përpjekjet kundër trafikimit të personave. Presidenti mund të vendosë sanksione për vendet që nuk bëjnë asnjë përpjekje në këtë fushë.
- Krijon programe të ndërgjegjësimit publik dhe informimit, si dhe programe të zhvillimit ekonomik ndërkombëtar për të asistuar viktimat e mundshme.

<sup>64</sup><https://www.govinfo.gov/content/pkg/PLAW-106publ386/pdf/PLAW-106publ386.pdf>

<sup>65</sup>SEC. 102. PURPOSES AND FINDINGS, DIVISION A—TRAFFICKING VICTIMS PROTECTION ACT OF 2000 <https://www.govinfo.gov/content/pkg/PLAW-106publ386/pdf/PLAW-106publ386.pdf>

- Krijon task forcën federale për të asistuar në implementimin e Aktit për Mbrojtjen e Viktimave të Trafikimit.

## **Mbrojtja**

- I siguron mbrojtjen dhe asistencën viktimave të huaja të trafikimit, duke udhënë atyre dhe anëtarëve të familjes të drejtën e hyrjes në Programin federal të Mbrojtjes së Dëshmitarëve, si dhe përfitime të tjera shtetërore dhe federale të njëjta me ato të refugjatëve. Përfitimet përfshijnë edukimin, kujdesin shëndetësor, trajnimet dhe programe të tjera të shërbimeve sociale.
- Viktimat e trafikimit informohen në lidhje me të drejtat e tyre dhe shërbimet e përkthimit.
- Vendos vizat T, e cila lejon viktimat e trafikimit të bëhen rezidentë të përkohshëm në SHBA, e më tej rezident të përhershëm pas tre vitesh. Pjesë janë edhe disa anëtarë të afërt të familjes. Viza T i jepet edhe :
  1. Viktimave “tëformave më të këqija të trafikimit”;
  2. Që janë fizikisht në SHBA për shkak të trafikimit;
  3. Ata që janë pjesë e asistencës në hetim dhe ndjekje penale të veprave penale të trafikimit;
  4. Ata që do të vuanin pasoja ekstreme (këtu nuk përfshihen të miturit);

## **Ndjekja penale – Forcimi i ndjekjes penale dhe dënimit të trafikantëve**

- Njih trafikimin si krim federal duke vendosur dënime të rënda.
- Prezanton vepra të reja penale të punës së detyruar; trafikimin si skllavëri, shërbime shtëpiake të detyruara, apo punë e detyruar; trafikimin me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit, si edhe kriminalizon përpjekjen për tu përfshirë në këtë vepër penale.
- Urdhëron dëmshpërblimin/kompensimin e viktimave.

*Dëmshpërblimi i detyrueshëm*

*“(a) Pavarësisht nenit 3663 ose 3663A, dhe përveç çdo dënimi tjetër civil ose penal të autorizuar me ligj, gjykata do të urdhërojë dëmshpërblimin për çdo shkelje sipas këtij kapitulli.*

*“(b)(1) Urdhri i dëmshpërblimit sipas këtij neni i kërkon të paditurit që t’i paguajë viktimës (përmes mekanizmit përkatës të gjykatës) shumën e plotë të humbjeve të viktimës, siç përcaktohet nga gjykata sipas paragrafit (3) të këtij nënseksioni.*

*“(2) Një urdhër dëmshpërblimi sipas këtij neni do të lëshohet dhe zbatohet në përputhje me nenin 3664 në të njëjtën mënyrë si urdhri sipas nenit 3663A.*

*“(3) Siç përdoret në këtë nënseksion, termi 'shuma e plotë e humbjeve të viktimës' ka të njëjtin kuptim siç parashikohet në nenin 2259 (b) (3) dhe përveç kësaj, i pandehuri duhet të përfshijë të ardhurat ose vlerën bruto të shërbimeve, ose punës së viktimës, ose e vlerës së punës të viktimës të garantuar sipas pagës minimale dhe garancive për punën jashtë orarit të Ligjit të Standardeve të Barabartatë Punës (29 USC 201 et seq.).<sup>66</sup>*

Më tej ky akt pësoi një sërë ndryshimesh e përmirësimesh me qëllim forcimin e luftës kundër trafikimit të personave nëpërmjet marrjes së masave ndaj formave të reja të shfaqjes së fenomenit, përfshirjes së institucioneve në identifikimin e viktimave, parashikimin e fondeve të veçanta për programet e asistencës etj.

Ndryshimet e vitit 2003 ndër të tjera autorizonin një fond prej 200 milion \$ për të luftuar trafikimin e personave. Ajo çka ishte më e rëndësishmja ishte zgjerimi i rrethit të personave që përfitojnë mbështetje sociale edhe me anëtarët e familjes së viktimës.

Gjithashtu, në ndryshimet e vitit 2003 u përcaktua detyrimi i Prokurorit të Përgjithshëm për të raportuar përpara Kongresit në lidhje me aktivitetet e qeverisë amerikane kundër trafikimit të personave.

<sup>66</sup> § 1593. Mandatory restitution, Trafficking Victims Protection Act of 2000  
<https://www.govinfo.gov/content/pkg/PLAW-106publ386/pdf/PLAW-106publ386.pdf>

Në 2005, ndryshimet adresojnë ndër të tjera krijimin e një programi pilot për vendosjen e të miturve viktime të dhunës në familje apo trafikimit në qendra rezidenciale si dhe programet parandaluese për turizmin seksual.

Ndryshimet në vitin 2008 u fokusuan kryesisht në shfrytëzimin për punë, duke kërkuar nga Departamenti i Punës parandalimin e shtetasve Amerikanë të përdorin produkte të ardhura nga puna e skllëve apo fëmijëve si dhe shfrytëzimin e fëmijëve si ushtarë. Gjithashtu, ndryshimet përfshinë edhe përfitimin financiar nga trafikimi i personave.

### **Akti “Për parandalimin e trafikimit për prostitucion dhe forcimin e familjes” 2014**

Akti “Për parandalimin e trafikimit për prostitucion dhe forcimin e familjes” i vitit 2014 kërkon të reduktojë trafikimin me qëllime seksuale të të rinjve në sistemin “Foster Care”.

Pjesa e këtij ligji specifik për trafikimin me qëllime prostitucioni kërkon nga sistemi i mirëqenies së fëmijëve, të përmirësojë përgjigjen ndaj trafikimit, duke identifikuar të rinjtë që janë viktime të trafikimit për qëllime seksuale, apo ata që janë në risk për trafikimin me qëllim seksual, të sigurojnë shërbimet e duhura për të rinjtë që kanë qenë pre e trafikimit për qëllime seksuale, të raportojnë fëmijët e humbur tek Qendra Kombëtare për fëmijët e humbur dhe të shfrytëzuar, dhe të zhvillojnë protokolle për gjetjen e fëmijëve të humbur apo të larguar, dhe të përcaktojnë rrethanat me të cilat janë përballur kur janë larguar nga kujdesi, duke përfshirë këtu edhe identifikimin nëse kanë qenë viktime trafikimi.

Më tej, agjensitë shtetërore për mirëqenien e fëmijëve kërkohet të raportojnë pranë autoriteteve të zbatimit të ligjit për rastet e trafikimit me qëllime seksuale dhe të sigurojnë/japin informacion për sa i përket viktimave të trafikimit me qëllime seksuale, apo të rinjve në risk, tek departamenti Amerikan i Shëndetit dhe Shërbimeve Shoqërore, i cili më pas do të raportojë këto raste në Kongres.

### **Akti Drejtësi për Viktimat e Trafikimit 2015<sup>67</sup>**

Akti Drejtësi për Viktimat e Trafikimit përmirëson reagimin e SHBA ndaj trafikimit të personave dhe përmban një numër ndryshimesh që forcojnë shërbimet ndaj viktimave.

---

<sup>67</sup><https://www.congress.gov/bill/114th-congress/senate-bill/178>

Ndryshimet nëpërmjet këtij akti u fokusuan gjithashtu edhe në fuqizimin e të mbijetuarve nga trafikimi duke përcaktuar ngritjen e Bordit të Këshillimit të Shteteve të Bashkuara mbi trafikimin e personave, mandat i të cilit përfundon në shtator 2020. Ky bord këshillon dhe i jep rekomandime Grupit të Politikavë të krijuar me aktin Për mbrojtjen e viktimave të trafikimit i vitit 2000, si dhe Task Forcës për Monitorimin dhe Luftën kundër Trafikimit të Personave.

### **Eksperienca në Mbretërinë e Bashkuar**

Në vitin 2015 Parlamenti Britanik miratoi aktin për Skllavërinë Moderne<sup>68</sup>, i cili hyri në fuqi në korrik 2015. Përpara miratimit të tij, trafikimi trajtohej në statute të ndryshme ku përfshiheshin:

- Akti për Shtetësinë, Imigracionin dhe Azilin – icili kriminalizonte trafikimin e personave për prostitucion;
- Akti për krimet seksuale 2003 – kriminalizonte trafikimin për të gjitha format e shfrytëzimit seksual;
- Akti për Azilin dhe Imigrimin – kriminalizonte trafikimin e personave për çdo qëllim, duke përfshirë edhe punën e detyruar;
- Akti për drejtësinë dhe hetuesinë 2009 – kriminalizonte detyrimin e një personi nga një person tjetër për të kryer një punë të detyruar.

Akti i ri i vitit 2015 është i ndarë në shtatë pjesë dhe shfuqizon veprat penale të përcaktuara në aktet e sipërpërmendura.

- Pjesa e parë qartëson veprat penale ekzistuese të skllavërisë dhe trafikimit të personave duke dhënë përkufizimet përkatëse si për veprën penale, kuptimin dhe llojet e shfrytëzimit dhe përcaktimin e dënimeve.
- Pjesa e dytë parashikon dhënien e dy urdhrave të rinj civil parandalues, Urdhri Parandalues për skllavërinë dhe trafikimin dhe urdhri për rrezikun e skllavërisë dhe trafikimit.

#### ***Urdhrat për parandalimin e trafikimit dhe skllavërisë***

<sup>68</sup>[http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2015/30/pdfs/ukpga\\_20150030\\_en.pdf](http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2015/30/pdfs/ukpga_20150030_en.pdf)



(1) Gjykata mund të lëshojë një urdhër për parandalimin e trafikimit dhe skllavërisë kundër një personi ("i pandehuri") kur trajton të pandehurin në lidhje me:–

(a) dënimin për skllavëri ose trafikim personash;

(b) kur konstatohet se i pandehuri nuk shpallet fajtor për veprën penale të skllavërisë apo trafikimit të personave për të cilën akuzohet për shkak të aftësive të kufizuara;

(c) kur konstatohet se i pandehuri është me aftësi të kufizuara dhe e ka kryer veprën penale të skllavërisë apo trafikimit të personave për të cilën akuzohet;

(2) Gjykata mund të vendosë vetëm nëse bindet se:

(a) ekziston rreziku që i pandehuri mund të kryejë njëvepër të skllavërisëose trafikimit të personave; dhe

(b) është e nevojshme të lëshohet urdhri me qëllim mbrojtjennë përgjithësi tëpersonave, ose personave të veçantë, nga dëmi fizik ose psikologjik që ka gjasa të ndodhë nëse i pandehuri e ka kryer një shkelje të tillë.

#### **Urdhrat për rreziktë skllavërisë dhe trafikimit**

(1) Gjykata mund të lëshojë një Urdhër për rreziktë skllavërisë dhe trafikimit kundër njëpersoni ("i pandehuri") mbi bazën e një kërkesë nga-

(a) një shef i policisë,

(b) një oficer i emigracionit, ose

(c) Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Krimin ("Drejtori Përgjithshme").

(2) Gjykata mund ta lëshojë Urdhrin vetëm nëse provohet se i pandehuri ka vepruar

në një mënyrë që nënkupton se:

(a) ekziston rreziku që i pandehuri do të kryejë një vepër penale tëskllavërisë ose trafikimit të personave ;dhe

(b) është e nevojshme të bëhet urdhri me qëllim mbrojtjene personavenë përgjithësi, ose personave të veçantë, nga dëmi fizik ose psikologjik që mund të ndodhë nëse i pandehuri do të kryente një vepër të tillë penale<sup>69</sup>.

- Pjesa e tretë përcakton kompetencat për forcat detare në lidhje me anijet.

<sup>69</sup> Part 2, Prevention orders, [http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2015/30/pdfs/ukpga\\_20150030\\_en.pdf](http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2015/30/pdfs/ukpga_20150030_en.pdf)

- Pjesa e katërt parashikon krijimin e Zyrës së Komisionerit të Pavarur anti-skllavëri, si dhe përcakton funksionet e Komisionerit.
- Pjesa e pestë prezanton një numër të masave që fokusohen në mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave, duke përfshirë mandatin e mbrojtjes për viktimat e trafikimit dhe të skllavërisë, si dhe masat e vaçanta për dëshmitarët në procese gjyqësore.

***Udhëzime për identifikimin dhe mbështetjen e viktimave***

*(1) Sekretari i Shtetit duhet të nxjerrë udhëzime për autoritetet publike dhe persona të tjerë që Sekretari i Shtetit i konsideron të përshtatshme për:*

*(a) indikatorët që tregojnë se një person mund të jetë viktimë eskllavërisë ose trafikimit të personave;*

*(b) masat për ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes për personat të cilët ekziston dyshimi i arsyeshëm se mund të jenë viktimat të skllavërisë ose trafikimit të personave;*

*(c) masat për të përcaktuar nëse ekziston dyshimi i arsyeshëm se një person mund të jetë viktimë e skllavërisë ose e trafikimit të personave;*

*(2) Sekretari i Shtetit, nga koha në kohë, mund të rishikojë udhëzimet e lëshuara sipas nënseksionit (1).*

*(3) Sekretari i Shtetit duhet të marrë masa që udhëzimet e nxjerra ose të rishikuara nën këtë seksion të publikohen në një mënyrë që konsiderohet e përshtatshme nga Sekretari i Shtetit.<sup>70</sup>*

- Pjesa e gjashtë parashikon detyrimin e disa bizneseve që të informojnë në lidhje me hapat e ndërmarrë për eliminimin e skllavërisë dhe trafikimit si në biznesin e tyre, ashtu edhe furnizuesit.
- Pjesa e shtatë parashikon detyrimin e Sekretarit të Shtetit për të publikuar një raport mbi rolin e Autoritetit të Licensimit dhe çështjeve të tjera të përgjithshme të këtij akti.

## **Eksperiencia e Kosovës**

### **Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit**

<sup>70</sup> Pika 49, Modern Slavery Act; [http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2015/30/pdfs/ukpga\\_20150030\\_en.pdf](http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2015/30/pdfs/ukpga_20150030_en.pdf)

Ky ligj ka si qëllim parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave, mbrojtjen e viktimave të trafikimit, ofrimin e shërbime si dhe bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar në luftën ndaj këtij fenomeni.

- Në pjesën e parë të ligjit janë dhënë përkufizimet si për veprën penale ashtu edhe për viktimat e supozuare ato të trafikimit, si dhe një sërë termash të përdorura për këtë fenomen.
- Pjesa e dytë e ligjit parashikon autoritete për parandalimin dhe luftimin e fenomenit si dhe mbrojtjen e viktimave. Në nenin 8 të ligjit përcaktohet emërimi dhe kompetencat e koordinatorit kombëtar kundër trafikimit me njerëz.
- Pjesa e tretë e ligjit fokusohet në hetimin dhe ndjekjen penale, duke qartësuar si elementet e veprës penale të trafikimit, ashtu edhe metodat e hetimit dhe mënyrat e ushtrimit të ndjekjes penale. Kjo pjesë gjithashtu përcakton edhe kompetencat për identifikimin dhe mbrojtjen e viktimave, si dhe përjashtimin e tyre nga përgjegjësia penale, detyrim ky që rrjedh edhe nga Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore”.
- Pjesa e katërt fokusohet në ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit, riintegrimin, si dhe mbështetjen e qendrave që ofrojnë shërbime për këtë kategori personash. Kjo pjesë orienton dhe qartëson të gjitha hapat që ndërmerren për adresimin e të drejtave që prej identifikimit, rolin e përfaqësive diplomatike në vendet e destinacionit dhe kthimin vullnetar të asistuar të viktimave të huaja.
- Në pjesën e pestë ligji i dedikohet parandalimit dhe luftës ndaj trafikimit të të miturve, dhe pjesa e shtatë përshkruan llojet dhe mënyrat e marrjes së dëmshpërblimit nga ana e viktimave të trafikimit.

Në të tre praktikat e referuara, ligjvënësi i ka kushtuar vëmendjeve të gjitha hapave që duhen ndërmarrë për parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të personave, mbrojtjes së viktimave dhe koordinimit të veprimeve në këtë fushë.

Secili prej ligjeve përcakton autoritetin shtetëror që kryen koordinimin e veprimeve antitrafik në vend, duke përcaktuar edhe të drejtat dhe detyrimet e tij, praktikë e cila nuk ekziston aktualisht në Shqipëri.

Aktet gjithashtu, nëpërmjet përkufizimeve që japin si për veprën penale të trafikimit të personave, ashtu edhe për format e shfrytëzimit, mënyrën e kryerjes, lehtësojnë të kuptuarin dhe zbatimin e ligjit në praktikë.

## **KONKLUZIONE/REKOMANDIME:**

Nga një analizë paraprake të bërë nga Organizata “Të Ndryshëm & Të Barabartë” janë identifikuar disa nga avantazhet që ka hartimi i një ligji të veçantë për mbrojtjen e viktimave të trafikimit:

- Shërben si ligj kuadër në të cilin integrohen dhe plotësohen të gjitha masat për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke zgjidhur më së miri edhe mungesën e referimit të akteve të ndryshme që rregullojnë aspekte të veçanta të fushën antitrafikim;
- Shërben si një instrument për të garantuar një mbrojtje efektive me një qasje pro-viktimave;
- Përcakton qartë strukturat përgjegjëse dhe mekanizmat për mbrojtjen e viktimave të trafikimit dhe nxjerr në pah edhe përpjekjet dhe masat e shumta që janë marrë në këtë drejtim;
- Përmirëson koordinimin e përpjekjeve, të strukturave dhe mekanizmave në mbrojtjen e viktimave të trafikimit, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore;
- Shërben për krijimin e një skeme shtetërore kompensimi për viktimat e trafikimit dhe plotësimin e mangësive ligjore për kompensimin nëpërmjet procesit gjyqësor;
- Duke siguruar një mbrojtje më të mirë për viktimat e trafikimit nxit dhe përmirëson bashkëpunimin e tyre me strukturat e zbatimi të ligjit, që ndikon në mënyrë të drejtëpërdrejtë edhe në ecurinë e hetimit dhe gjyqimit të çështjeve me objekt trafikimin e qenieve njerëzore;
- Përmirëson procesin e identifikimit formal të viktimave të trafikimit sepse nxit identifikimin pro-aktiv dhe interesin e vetë viktimave për vetë-identifikim;
- Zgjidh edhe situatën e përcaktimit të statusit të viktimave të trafikimit, duke parashikuar edhe një mekanizëm ankimi në nivel administrativ dhe në rrugë gjyqësore, mekanizëm i cili mungon dhe nuk është i zgjidhur as në procedurat standarde të veprimit

Duke reflektuar edhe rekomandimet dhe sugjerimet e grupit ad-hoc<sup>71</sup> mendojme se Ligji i sugjeruar duhet të jetë në përputhje me standartet ndërkombëtare dhe duhet të përmbajë përcaktimet ligjore të qarta dhe të sjella në kontekstin shqiptar, duke përfshirë:

- qëllimet dhe objektivat e ligjit;
- parimet kryesore për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore;
- subjektet e parashikuara nga ligji për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore,;
- kompetencat e subjekteve të përfshira,;
- qendrat për mbështetje dhe asistencë;
- bashkëpunimin e Institucioneve të shërbimeve publike me organizata jofitimprurëse dhe qendrat që ofrojnë shërbime për, rehabilitimin social dhe mbrojtjen e viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit;
- detyrimet e përfaqësive diplomatike dhe zyrave konsullore, ndihmën për fëmijët viktima të trafikimit;
- garancitë shtetërore për viktimat e trafikimit njerëzor, bashkëpunimin ndërkombëtar në luftën kundër trafikimit.

Një ligj me fokus mbrojtjen e viktimave të trafikimit do të:

- ✓ konsolidonte dhe qartësonte autoritetet e zbatimit të ligjit në hapat që duhet të ndërmarrin në luftën, parandalimin e trafikimit të personave dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit;
- ✓ krijojë institucionin e koordinatorit kombëtar dhe përcaktojë kompetencat dhe rolin e tij në funksion të koordinimit të veprimeve antitrafik, në nivel kombëtar e ndërkombëtar, si dhe të llogaridhënies së tij;
- ✓ krijojë mekanizmin për kompensimin e drejtpërdrejtë të viktimave të trafikimit;
- ✓ qartësojë mënyrën e marrjes së statusit “viktimë trafikimi”, si dhe të përcaktojë autoritetin e dhënies së këtij statusi, si dhe të drejtën për të ankimuar aktin administrativ.

---

<sup>71</sup> Ngritur në zbatim të VKM Nr. 770, datë 26.12.2018, **aktiviteti 1.(a).6.**, për “*Ngritjen e një grupi ad-hoc për kryerjen e një analize dhe vlerësimi të thelluar mbi nevojën për një ligj të veçantë me fokus mbrojtjen e viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit*”.

Sa më sipër rekomandojmë që ligji të ketë për qëllim përcaktimin e dispozitave juridike përmes të cilave autoriteteve kompetente u caktohen përgjegjësitë dhe kompetencat në lidhje me:

1. Koordinatorin Kombëtar Anti-trafik, përcaktimin e tij si njësi buxhetore më vete dhe detyrmin për të raportuar mbi hapat që qeveria Shqiptare ndërmerr për mbrojtjen e viktimave të trafikimit, fëmijëve apo familjarëve të tyre, si dhe luftës dhe parandalimit të trafikimit të personave.
2. Autoritetet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor si dhe trajnimin e tyre të detyrueshëm për të trajtuar rastet që prej identifikimit fillestar të tyre.
3. Parandalimin dhe luftimin e trafikimit të personave në të gjitha format, si atë të shfrytëzimit seksual, emigracionit të paligjshëm, përfshirë shfrytëzimin për punë dhe lypjen e detyruar apo çdo formë tjetër që shfaqet ai.
4. Mbrojtjen e viktimave të trafikimit, fëmijëve të tyre, apo familjarëve, sigurimin e të drejtave të tyre si: ndihmën juridike, mjekësore, mbështetjen psiko sociale, sigurimin e kompensimit për të gjithë personat që supozohet të jenë, ose që identifikohen si të trafikuar përmes një qasje tek të drejtat e njeriut, në përputhje të plotë me standardet ndërkombëtare;
5. Bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar me qëllim parandalimin dhe luftimin e trafikimit të personave.

Me anë të këtij ligji do të bëhej e mundur dhënia e përkufizimeve për:

- Trafikimin
- Format e trafikimit/shfrytëzimit
- Viktimat e trafikimit
- Viktimat e mundshmetëtrafikimit
- Vulnerabiliteti
- Rehabilitimi
- Reintegrimi
- Të afërmit e viktimës
- Të miturit e trafikuar apo shfrytëzuar
- Puna e detyruar e atë shfrytëzuese
- Emigracioni klandestin apo kontrabandimi i emigrantëve
- Adoptimi i paligjshëm

- Martesa e detyruar
- Shfrytëzimi i viktimës<sup>72</sup>

Apo edhe përcaktimi i autoriteteve përgjegjëse për luftimin e parandalimin e fenomenit, si dhe mbrojtjen e viktimave duke filluar:

- Këshilli i Ministrave dhe Ministrinë përkatëse
- Koordinator Kombëtar Antitrafik
- Zyra e Koordinatorit Kombëtar Antitrafik
- Mekanizmi Kombëtar i Referimit
- Task Forca
- Organizatat joqeveritare dhe roli i tyre
- Mbrojtësit e viktimave të trafikimit
- Pushteti vendor
- Institucionet arsimore apo shëndetësore<sup>73</sup>

Ligji duhet të rendisë autoritetet për parandalimin dhe luftimin e trafikimit të personave dhe mbrojtjes së viktimave të trafikimit duke i listuar në ato ekzekutive, legislative, gjyqësore dhe prokurorinë, duke i organizuar në kuptimin e autoritetit kombëtar kundër trafikimit.

Duke patur një ligj të tillë do të bëhej i mundur që Koordinator Kombëtar Antitrafik dhe Mekanizmi Kombëtar i Referimit të mund të gjenin përcaktim në nivel ligjor, duke përcaktuar detyrat dhe kompetencat e tij.

Ligji të përcaktojë modalitetet e veprimit dhe çfarë duhet të bëhet për parandalimin dhe luftimin, duke përcaktuar veprimet konkrete që duhet të bëjnë autoritetet si identifikimin fillestar apo formal, koordinimin institucional, edukimin, trajnimin, informimin, veprimet detyruese të punonjësve të policisë, pushtetit vendor, drejtësisë, inspektorët e punës, punonjësit e kujdesit social e shëndetësor, zyrat konsullore etj.

---

<sup>72</sup>Kini parasysh që kjo nuk është një listë shteruese

<sup>73</sup> Kini parasysh që kjo nuk është një listë shteruese



Ligji të parashikojë elementët pararendës të ndjekjes penale, duke u ndalur tek veprimet proaktive, skuadrat e përbashkëta të hetimit, apo të identifikojë vepra që ndërlidhen me trafikimin.

Ligji duhet të parashikojë dispozita në lidhje me identifikimin e viktimave të trafikimit, dhënien e statusit dhe format e ankimimit të aktit administrativ.

Përrjashtimin nga përgjegjësia penale e parashikon KP në nenin 52/a të tij, por ligji mund të rëndisë veprimet që duhet të përjashtohen nga përgjegjësia penale e viktimës së trafikimit si:

- Hyrja dhe dalja e paligjshme
- Sigurimi apo përdorimi i dokumenteve të fallsifikuara
- Apo veprime të tjera të përfshirjes në veprimtari të tjera të paligjshme, si posedimi i lëndëve narkotike, etj, duke theksuar se kjo përfshirje duhet të jetë pasojë direkte e situatës së trafikimit.

Ligji do të përcaktojë përgjegjësinë e personave juridikë kur personat veprojnë në emër të tyre, apo kur mungesa e mbikqyrjes apo kontrollit ka sjellë si pasojë trafikimin.

Ligji mund të përcaktojë disa dispozita mbi trajtimin gjatë hetimeve e gjykimit të ngjashme me ato të parashikuara nga Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 5 prillit 2011 “Mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi” dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA. Në këto akte jepen përkufizime përshkruese të qarta në lidhje me trafikimin, viktimat e trafikimit, mbrojtjen e tyre, atë të veçantë të fëmijëve, mbi punën e detyruar si formë skllavërie, lejet e qëndrimit të viktimave të trafikimit nga vendet e treta dhe një përcaktim më të mirë të strukturave, detyrave, përgjegjësisve dhe standardeve minimum në mekanizmat antitrafikim. Neni 12 i Direktivës parashikon:

- Të mos ketë përsëritje të panevojshme të seancave intervistuese e gjyqësore
- Të mos ketë kontakte vizuale në mes të viktimës dhe të akuzuarit
- Të evitohet dhënia e dëshmisë në seancë të hapur
- Të evitohet pyetja e panevojshme në lidhje me jetën private

Në mënyrë të veçantë direktiva parashikon skemën e mbrojtjes, asistencës, parandalimit e sidomos për viktimat fëmijë të pashoqëruar etj.

Neni 12, i Konventës së Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual parashikon masat konkrete legislative që duhet të marrëçdo palë “Çdo palë merr masat e nevojshme legislative ose masa të tjera për të siguruar se rregullat e konfidencialitetit, të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm kombëtar për profesionistë të caktuar që kërkohen të punojnë në kontakt me fëmijët, nuk përbëjnë pengesë për mundësinë e raportimit tek shërbimet përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve të çdo situatëkur këta profesionistë kanë shkaqe të arsyeshme për të besuar se një fëmijë është viktimë e shfrytëzimit seksual ose e abuzimit seksual”.

Ligji duhet të parashikojë në mënyrë të veçantë:

- Detyrat dhe përgjegjësitë e Koordinatorit Kombëtar anti-trafik ;
- Ndihmën dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit;
- Trajtimin e viktimave të trafikimit fëmijë si dhe fëmijët e viktimave të trafikimit dhe familjarët e tyre si kapitull i veçantë në ligj ;
- Mbyllja e objekteve dhe bizneseve që janë të përfshira dhe mundësojnë trafikimin e personave, apo qëpërfitojnë nga puna e viktimave te trafikimit;
- Mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë;
- Sigurimi i viktimave apo dëshmitarëve;
- Rehabilitimi dhe reintegrimi i viktimave;
- Sigurimi dhe mbështetja e qendrave që asistojnë/strehojnë VT/VMT;
- Aftësimi profesional i VT;
- Informimi në lidhje me procedurën për pajisjen me leje qëndrimi;
- Periudha e reflektimit për viktimatdhe dëshmitarët e trafikimit të personave;
- Shërbimet e ofruara që në momentin e identifikimit;
- Qëndrimi i viktimave dhe dëshmitarëve të trafikimit;
- Kthimi vullnetar i asistuar për VT/VMT;
- Bashkëpunimi ndërkombëtar për kthimin vullnetar të asistuar
- Dhënia e ndihmës dhe mbrojtjes për VT/VMT nga misionet diplomatike dhe zyrat konsullore;
- Roli i organizatave;
- Dispozita të përgjithshme lidhur me ndihmën dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimat;
- Parimet e posaçme të luftës kundër trafikimit të fëmijëve;

- Prezumimi i moshës
- Kthimi vullnetar i asistuar i fëmijëve viktima
- Dhënia e ndihmës dhe mbrojtjes
- Zgjidhja e çështjes së kompensimit
- Llojet e kompensimeve:
  - Dëmshtëpërblimi i urdhëruar nga Gjykata
  - Urdhrrat e kompensimit
  - Kompensimi nga shteti
  - Kompensimi i viktimave fëmijë
  - Kërkesa për kompensim nga shteti
- Bashkëpunimi mes autoriteteve
- Nxjerrja e akteve nënligjore
- Hyrja në fuqi

## BIBLIOGRAFIA

- Konventa e Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Nderkombëtar, të ratifikuar me ligjin nr. 8920, datë 11.07.2002 “Për ratifikimin e “Konventës së Kombeve të Bashkuara Kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar” dhe dy protokolleve shtesë të saj”.
- Deklarata e Parimeve Themelore të Drejtësisë për Viktimat e Krimeve dhe të Abuzimit të Pushtetit adaptuar në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara në vitin 1985.
- Konventa e Këshillit të Europës “Për masat kundër trafikimit të qënieve njerëzore “ , e ratifikuar me ligjin nr. 9642 datë 20.11.2006.
- Konventa e Këshillit të Evropës për “Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi Seksual”.
- Vendimi Kuadër i BE mbi Statusin e Viktimave në Gjykimin Penal e datës 15.03.2001,
- Direktiva 2011/36BE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit të 5 prillit 2011, mbi parandalimin dhe luftën kundër trafikimit të qënieve njerëzore dhe mbrojtjen e viktimave të këtij trafikimi, dhe zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2002/629/JHA.
- Direktiva 2012/29/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit të 25 tetorit 2012 “Vendosja e Standardeve Minimum mbi të Drejtat, Mbështetjen dhe Mbrojtjen e Viktimave të Krimit dhe Zëvendësimi i Vendimit Kuadër të Këshillit 2001/220/JHA.
- Konventa e Këshillit të Europës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual, e ratifikuar nga Parlamenti shqiptar me ligjin nr. 10 071 datë 9.2.2009.
- Kodi i Procedures Penale i RSH, sipas ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017.
- Kodi Penal i RSH.
- Ligji nr. 37/2017 datë 30.03.2017 “Kodi i Drejtësisë për të Miturit”.
- Ligji nr.9205 dt.15.03.2004’’Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë’, i ndryshuar me ligjin nr. 10 173 datë 22.10.2009 dhe ligjin nr. ligjin nr. 32/2017 datë 30.03.2017.
- The UN Declaration of Basic Principles of Justice for Victims of Crime and Abuse of Power (1985). URL: <http://www.unhcr.ch>.
- Draft basic principles and guidelines on the right to restitution, compensation and rehabilitation for victims of gross violations of human rights and fundamental freedoms (1997).URL:[www.unhcr.ch](http://www.unhcr.ch).
- Vendime të Gjykatës së Krimeve të Rënda dhe Gjykatës së Lartë [www.gjkr.gov.al](http://www.gjkr.gov.al)
- [www.gjykataelarte.gov.al](http://www.gjykataelarte.gov.al).

- Ligji nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.
- Ligji për parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe mbrojtja e viktimave të trafikimit (Kosovë).
- Modern Slavery Act,
- [http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2015/30/pdfs/ukpga\\_20150030\\_en.pdf](http://www.legislation.gov.uk/ukpga/2015/30/pdfs/ukpga_20150030_en.pdf)
- Justice for Victims of trafficking act 2015 <https://www.congress.gov/bill/114th-congress/senate-bill/178>.
- Vendimi Nr. 518, datë 4.9.2018 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar”
- Vendimi nr. 707, datë 26.8.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 107, datë 10.2.2010, të Këshillit të Ministrave, “për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 141/2014 për disa shtesa në ligjin nr. 10383, datë 24.2.2011, "Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.